

**Organizata për siguri dhe bashkëpunim evropian  
MISIONI NË KOSOVË  
Departamenti për të drejtat e njeriut dhe sundim të së drejtës**

**Seksioni për monitorimin e sistemit juridik**

**KOSOVË  
SHQYRTIMI I SISTEMIT TË GJYQËSISË PENALE  
“ADMINISTRIMI DREJTËSISË NËPËR GJYKATAT KOMUNALE”**

(mars 2004)

<b>PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE .....</b>	<b>4</b>
<b>PJESA 1.....</b>	<b>5</b>
<b>HISTORIKU .....</b>	<b>5</b>
A. MANDATI I SEKSIONIT PËR MONITORIMIN E SISTEMIT JURIDIK.....	5
B. QËLLIMI DHE SHTRIRJA E RAPORTIT .....	6
C. GJYKATAT .....	6
1. <i>Struktura dhe kompetenca teritoriale e gjykatave</i> .....	6
2. <i>Kompetenca lëndore</i> .....	7
<b>PJESA 2.....</b>	<b>8</b>
<b>E DREJTA E GJYKIMIT NË KOHË TË ARSYESHME .....</b>	<b>8</b>
A. LIGJI NË FUQI – VENDËS DHE NDËRKOMBËTAR.....	8
B. GJETJET.....	9
1. <i>Shkaqet organizative të vonesave (shtyrjeve)</i> .....	10
2. <i>Vonesat gjatë procedurës së gjyqimit</i> .....	14
C. KODI I PËRKOQSHËM I PROCEDURËS PENALE I KOSOVËS .....	17
D. KONKLuzion .....	18
<b>PJESA 3.....</b>	<b>19</b>
<b>E DREJTA E GJYKIMIT NGA TRIBUNALI I THEMELUAR ME LIGJ.....</b>	<b>19</b>
A. LIGJI NË FUQI – VENDËS DHE NDËRKOMBËTAR.....	19
B. GJETJET.....	19
C. KODI I PËRKOQSHËM I PROCEDURËS PENALE I KOSOVËS .....	20
<b>PJESA 4.....</b>	<b>21</b>
<b>E DREJTA PËR TRIBUNAL TË PAANSHËM .....</b>	<b>21</b>
A. LIGJI NË FUQI – VENDËS DHE NDËRKOMBËTAR.....	21
B. GJETJET.....	22
1. <i>Procedura e shkurtuar (sumare)</i> .....	22
2. <i>Procedura për të mitur</i> .....	23
3. <i>Rigjykimet</i> .....	24
C. KODI I PËRKOQSHËM I PROCEDURËS PENALE I KOSOVËS .....	25
<b>PJESA 5.....</b>	<b>26</b>
<b>E DREJTA E GJYKIMIT PUBLIK.....</b>	<b>26</b>
A. LIGJI NË FUQI – VENDËS DHE NDËRKOMBËTAR.....	26
B. GJETJET.....	27
C. KODI I PËRKOQSHËM I PROCEDURËS PENALE I KOSOVËS .....	28
<b>PJESA 6.....</b>	<b>29</b>
<b>E DREJTA E MARRJES NË PYETJE TË DËSHMITARIT.....</b>	<b>29</b>
A. LIGJI NË FUQI – VENDËS DHE NDËRKOMBËTAR.....	29
B. GJETJET.....	29
C. KODI I PËRKOQSHËM I PROCEDURËS PENALE I KOSOVËS .....	30
<b>KONKLuzion .....</b>	<b>31</b>

<b>REKOMANDIMET .....</b>	<b>32</b>
<b>SHTOJCA 1 GJYQTARËT E GJYKATAVE KOMUNALE .....</b>	<b>34</b>
<b>SHTOJCA 2 LËNDËT PËR NJË GJYKATË .....</b>	<b>35</b>
<b>SHTOJCA 3 LLOJET E LËNDËVE.....</b>	<b>37</b>
<b>SHTOJCA 4 LËNDËT ME TË MITURIT .....</b>	<b>38</b>
<b>SHTOJCA 5 NORMA PËR NJË GJYQTAR.....</b>	<b>39</b>

-

## PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Puna e gjykatave komunale ka rëndësi kyçe në administrimin e drejtësisë dhe ndërtimin e sundimit të së drejtës në Kosovë. Janë 24 gjykata komunale të cilat punojnë në Kosovë dhe merren me lëndët civile, lëndët me të miturit dhe lëndët penale të cilat bartin dënimin maksimal prej pesë vjetësh heqje lirie. Gjykatat komunale si të tilla e luajnë rolin kryesor në zgjidhjen e konflikteve juridike në shoqëri dhe bën pjesë në instancën gjyqësore me të cilën njerëzit më së shpeshti kontaktojnë. Për këtë arsye funksionimi i gjykatave komunale ka ndikim të madh në atë se si e percepton opinioni publik administrimin e drejtësisë si tërësi – pra korrektësinë dhe efikasitetin e tij.

Si rezultat i përcjelljes së zhvillimit të proceseve gjyqësore penale, Misioni i OSBE-së në Kosovë ka vërejtur se administrimi i drejtësisë nëpër gjykatat komunale vuan nga një sërë të metash, të cilat mund të ndikojnë dëmshëm në të drejtën e të akuzuarit në gjykim të drejtë. Ky raport merret me pesë aspekte kryesore lidhur me të drejtën për gjykim të drejtë, respektivisht, të drejtën e gjykimit brenda kohës së arsyeshme, të drejtën e gjykimit nga tribunali i themeluar me ligj, të drejtën për gjykatë të paanshme, të drejtën në gjykim publik dhe të drejtën e marrjes në pyetje të dëshmitarit.

Duke identifikuar çështjet ligjore, praktike dhe strukturore të cilat ndikojnë në të drejtat e lartpërmendura, Misioni i OSBE-së në Kosovë ka dalë me një numër rekomandimesh të cilat kanë për qëllim zhvillimin e sistemit gjyqësor komunal, si nga aspekti i efikasitetit ashtu edhe i drejtësisë së gjykimeve. Autoritetet relevante inkurajohen që t'i implementojnë këto ndryshime dhe t'i marrin të gjitha masat e nevojshme për të siguruar funksionimin e duhur të administrimit të drejtësisë nëpër gjykatat komunale.

Me hyrjen në fuqi të Kodit të procedurës penale të Kosovës<sup>1</sup>, me 6 prill 2004, do të eliminohen disa prej të metave ligjore të përmendura në këtë raport. Mirëpo shumica e problemeve do të mbeten, prandaj ende do të ketë nevojë që të adresohen nga autoritetet relevante.

---

<sup>1</sup> Rregullorja e UNMIK-ut 2003/26 mbi Kodin e përkohshëm të procedurës penale të Kosovës.

## PJESA 1

### HISTORIKU

Ky raport është përgatitur nga Seksioni për monitorim të sistemit juridik (SMSJ), i cili është pjesë përbërëse e Departamentit për të drejtat e njeriut dhe sundimin e së drejtës të Misionit të OSBE-së në Kosovë. OSBE-ja funksionon nën ombrellën e Administratës së përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK), në rolin e Shtyllës për ndërtimin e institucioneve.

Kjo pjesë ka për qëllim të ofrojë një historik të shkurtë lidhur me raportin dhe të paraqesë kontekstin institucional të SMSJ-së dhe Departamentit.

#### A. Mandati i seksionit për monitorimin e sistemit juridik

Rezoluta 1244 e Këshillit të Sigurimit (RKS 1244) e autorizon Sekretarin e Përgjithshëm të themelojë një prani civile ndërkombëtare në Kosovë, e cila do të siguronte një administratë të përkohshme. Njëra nga përgjegjësitë kryesore të kësaj pranie ndërkombëtare është edhe *“mbrojtja dhe promovimi i të drejtave të njeriut”*<sup>2</sup>

Sekretari i Përgjithshëm i KB-ve, në raportin e tij të paraqitur para Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, me 12 qershor 1999, rolin udhëheqës në ndërtimin e institucioneve në kuadër të UNMIK-ut, ia përcaktoi vetë OSBE-së, duke bërë me dije se njëra nga përgjegjësitë e Shtyllës për ndërtimin e institucioneve (Shtylla III) duhet të përfshijë monitorimin e të drejtave të njeriut dhe ndërtimin e kapaciteteve. Ai gjithashtu udhëzoi OSBE-në të zhvillojë mekanizma të koordinuar mirë me qëllim të lehtësimit të monitorimit të të drejtave të njeriut dhe funksionimin e duhur të sistemit gjyqësor:

*“UNMIK-u do të ketë bazën e monitorëve të të drejtave të njeriut dhe këshilltarëve të cilët do të kenë qasje të papenguar në të gjitha pjesët e Kosovës, për të bërë hetimet lidhur me cënimin e të drejtave të njeriut dhe për sigurimin e mbrojtjes së të drejtave të njeriut dhe çështjet e promovimit, të jenë të adresuara përgjatë aktiviteteve të gjithëmbarshme të misionit. Monitorët e të drejtave të njeriut, përmes zëvendësit të Përfaqësuesit Special për Ndërtimin e Institucioneve, do t’i raportojnë konstatimet e tyre Përfaqësuesit Special. Konstatimet e monitorëve të të drejtave të njeriut do të bëhen publike në mënyrë të rregullt dhe do të ndahen, sipas nevojës, edhe me mekanizmat e të drejtave të njeriut në kuadër të Kombeve të Bashkuara, në konsultim me zyren e Kombeve të Bashkuara të Komisarit të lartë për të drejtat e njeriut. UNMIK-u do të siguroj raportim të koordinuar dhe aftësi përgjegjëse.” (Para.87)*

Në Letrën e marrëveshjes, e datuar më 19 korrik 1999, në mes të nën-Sekretarit të Përgjithshëm për operacionet paqëruajtëse të Kombeve të Bashkuara dhe përfaqësuesit të udhëheqësit të zyrës së OSBE-së, qëndron se, Shtylla për ndërtimin institucional- (Shtylla III), OSBE duhet të zhvilloi mekanizmat të cilët sigurojnë, që gjykatat, tribunatet administrative dhe strukturat tjera gjyqësore, të veprojnë në pajtueshmëri me standardet ndërkombëtare të së drejtës penale dhe të drejtave të njeriut. Në kuadër të Misionit të OSBE-së në Kosovë, Departamenti për të drejtat e njeriut dhe sundimit të së drejtës ka përgjegjësi të monitorojë dhe raportojë mbi gjendjen e sistemit juridik në kontekst të sundimit të së drejtës dhe të drejtave të njeriut. Si seksion përkatës në kuadër të Departamentit, SMSJ-ja ka për detyrë të monitorojë rastet e ndryshme në kuadër të sistemit të

---

<sup>2</sup> Rezoluta 1244 e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, 12 qershor 1999, para. 11/j.

drejtësisë penale, duke vlerësuar pajtueshmërinë e tyre me standardet ndërkombëtare, si dhe të raportojë mbi çështjet shqetësuese në këtë fushë<sup>3</sup>.

## **B. Qëllimi dhe shtrirja e raportit**

Mandati i Misionit të OSBE-së në Kosovë përfshin monitorimin e sistemit gjyqësor si tërësi. Megjithëse, deri më tani, ky monitorim është koncentruar kryesisht në lëndët penale të kompetencës së gjykatave të qarkut, ndërtimi i sundimit të së drejtës dhe respektimi i të drejtave të njeriut kërkon funksionim të mirëfilltë të sistemit gjyqësor në të gjitha nivelet. Për këtë arsye, Misioni i OSBE-së në Kosovë e kryen monitorimin e sistemit të gjykatave komunale dhe e ka përgatitur këtë raport, me qëllim të ofrimit të një pasqyreje më të plotë të sistemit gjyqësor.

Ky raport i identifikon problemet dhe vështirësitë në kuadër të gjykatave komunale nga aspekti struktural dhe i nënvizon shqetësimet lidhur me rastet specifike në të cilat aktiviteti i gjyqësisë, administratorëve të saj, ose organeve të zbatimit të ligjit, kanë dështuar të respektojnë standardet dhe garancitë për gjykim të drejtë dhe proces të rregullt gjyqësor. Ky raport i paraqet rekomandimet mbi atë se si mund të adresohen këto shqetësime.

Ky raport gjithashtu i komenton ndryshimet të cilat mund të priten pas hyrjes në fuqi të Kodit të ri të procedurës penale (Rregullorja e UNMIK-ut 2003/26 për Kodin e përkohshëm të procedurës penale të Kosovës), më 6 prill 2004. Me kodin e ri do të adresohen disa nga problemet legjislative, përderisa tjerat, e veçanërisht problemet strukturale, do të mbeten edhe më tej të pazgjidhura.

Ky raport nuk ka intencë të paraqesë listën e tërë të vështirësive me të cilat përballohen gjykatat komunale, por mëton t'i paraqesë disa prej çështjeve më të rëndësishme të cilat ndikojnë në administrimin e drejtësisë dhe respektimin e të drejtave të njeriut.

## **C. Gjykatat**

Me 18 janar 2000, në Gjykatën e Qarkut të Gjilanit/Gnjilane, betimin e kanë dhënë 36 gjyqtarë dhe 4 prokurorë publik për të ushtruar detyrën në regjionin e Gjilanit/Gnjilane. Gjatë gjashtë javëve tjera, në katër regjionet tjera të Kosovës, janë mbajtur ceremoni të ngjajshme, të cilat e kanë shënuar fillimin e një sistemi të përtrirë juridiko-penal në Kosovë.

### **1. Struktura dhe kompetenca teritoriale e gjykatave**

Në Kosovë janë aktualisht 24 gjykata komunale, dhe secila prej tyre e mbulon territorin e një ose më shumë komunave.<sup>4</sup> Gjykatat më të reja të hapura janë, gjykata komunale e Leposaviqit/Leposavić dhe Zubin Potokut<sup>5</sup>. Përderisa gjykata komunale në Leposavić/Leposaviq

---

<sup>3</sup> Qarkorja e Departamentit të Drejtësisë 2001/15, e lëshuar më 6 qershor 2001, vërtetoi se monitoruesit e gjykimeve të SMSJ-së me disa përjashtime, duhet të gëzojnë qasje në të gjitha seancat gjyqësore dhe shkresat e lëndës. Kjo qarkore ka për qëllim të përmirësojë mirëkuptimin e gjyqësisë ndaj mandatit të OSBE-së, dhe të sigurojë që monitoruesit e gjykimeve të kenë mundësi të mbulojnë të gjitha fazat e procedurës penale.

<sup>4</sup> Si shtesë, duhet të theksohet se një departament i veçantë i gjykatës komunale në Ferizaj/Uroševac, ishte hapur në Shtërpce/Strpce në janar të vitit 2003, në pajtim me Urdhëresën Administrative nr. 2002/24 që implementon Rregulloren e UNMIK-ut nr. 1999/1 mbi Autoritetin e Administratës së Përkohshme në Kosovë. Gjykata në Shtërpce/Strpce ka mbajtur seancën e parë dëgjimore penale në nëntor 2003.

<sup>5</sup> Në Leposavić/Leposaviq dhe Zubin Potok, më heret kanë ekzistuar strukturat paralele gjyqësore, shih raportin e Misionit të OSBE-së në Kosovë mbi *Strukturat paralele në Kosovë*, tetor 2003, f. 16.

e ka përfunduar në vitin 2003 lëndën e parë të saj penale, gjykata në Zubin Potok ende nuk i ka përfunduar lëndët penale.

Ekzistojnë pesë gjykata të qarkut në Kosovë, nga një për secilin regjion. Këto gjykata janë të instancës së dytë për lëndët e kryera nga gjykatat komunale dhe e mbulojnë kompetencën teritoriale për katër, pesë ose gjashtë gjykata komunale.<sup>6</sup> Gjykatat e qarkut dhe ato komunale janë paraqitur në listën si në vijim:

<p><u>Gjykata e Qarkut në Prishtinë/Priština</u>            Gjykata Komunale në Ferizaj/Uroševac            (Departamenti në Shtërpçë/Štrpce)            Gjykata Komunale në Glllogovc/Glogovac            Gjykata Komunale në Lipjan/Lipljan            Gjykata Komunale në Prishtinë/Priština            Gjykata Komunale Podujevë/Podujevo            Gjykata Komunale Kaçanik/Kacanik</p>	<p><u>Gjykata e Qarkut në Prizren</u>            Gjykata Komunale në Dragash/Dragaš            Gjykata Komunale në Malishevë/Mališevo            Gjykata Komunale në Prizren            Gjykata Komunale në Rahovec/Orahovac            Gjykata Komunale në Suharekë/Suha Reka</p>
<p><u>Gjykata e Qarkut në Gjiilan/Gnjilane</u>            Gjykata Komunale në Gjiilan/Gnjilane            Gjykata Komunale në Kamenicë/Kamenica            Gjykata Komunale në Viti/Vitina</p>	<p><u>Gjykata e Qarkut në Mitrovicë/Mitrovica</u>            Gjykata Komunale në Leposavić/Leposaviq            Gjykata Komunale në Mitrovicë/Mitrovica            Gjykata Komunale në Skenderaj/Srbica            Gjykata Komunale në Vushtrri/Vučitrn            Gjykata Komunale në Zubin Potok</p>
<p><u>Gjykata e Qarkut në Pejë/Peć</u>            Gjykata Komunale në Deçan/Dečani            Gjykata Komunale në Gjakovë/Đakovica            Gjykata Komunale në Istog/Istok            Gjykata Komunale në Klinë/Klina            Gjykata Komunale në Pejë/Peć</p>	

Instanca e tretë dhe e fundit gjyqësore, me kompetencë teritoriale që mbulon tërë territorin e Kosovës, është Gjykata Supreme e Kosovës.<sup>7</sup>

## 2. Kompetenca lëndore

Gjykatat komunale janë kompetente për gjykimin e lëndëve penale për të cilat dënimi maksimal është paraparë të jetë deri në pesë vjet heqje lirie. Krahas kësaj, këto gjykata janë kompetente edhe për vjedhje të rënda, kundërvajtjet e rënda kundër sigurisë së komunikacionit publik, kontestet pronësore juridike, nga marrëdhëniet e punës, për kujdestarinë, trashëgiminë, përmbarimin e vendimeve dhe të gjitha lëndët për zgjidhjen e të cilave është kompetent gjyqtari individual.<sup>8</sup> Neni 21 dhe 23 i Kodit të përkohshëm të procedurës penale e rregullon kompetencën e gjykatave komunale. Sipas këtyre dispozitave gjykatat komunale do të jenë kompetente për gjykimin në shkallë të parë të veprave penale të dënueshme me gjobë ose heqje lirie deri në pesë vjet, përveq rasteve kur ato bijnë nën kompetencën e gjykatës së qarkut. Nuk është bërë referencë ndaj veprave të caktuara penale.

<sup>6</sup> Neni 35 i Ligjit për gjykatat e rregullta, Gazeta Zyrtare e KSA të Kosovës, nr. 21/78, 49/79, 44/82, 44/84, 18/87, 14/88 dhe 2/89.

<sup>7</sup> Krahas gjykatave komunale, të qarkut dhe asaj supreme ekziston edhe struktura e gjykatave për kundërvajtje. Momentalisht punojnë 25 gjykata komunale për kundërvajtje, secila nga to duke mbuluar një apo më shumë komuna. Si shkallë e dytë për lëndët e këtyre gjykatave është Gjykata e Lartë për Kundërvajtje në Prishtinë/Priština. Shih nenin 39 të Ligjit për kundërvajtjet GZ e KSAK nr. 23/79, 44/84, 18/87, 9/88 dhe 21/88.

<sup>8</sup> Neni 26 i Ligjit për gjykatat e rregullta, i ndryshuar.

## PJESA 2

### E DREJTA E GJYKIMIT NË KOHË TË ARSYESHME

Pamundësia e sistemit gjyqësor që t'i procedojë lëndët në një kohë të arsyeshme mund ta pengojë administrimin e mirëfilltë të drejtësisë dhe, në lëndët penale, të ndikojë negativisht në të drejtën e personit të akuzuar që të gjykohet brenda kohës së arsyeshme.

Kjo pjesë e analizon problemin e vonesave nëpër gjykatat komunale si dhe shkaqet e mundshme. Për shkak se numri i lëndëve nëpër gjykata në tërësi si ato penale, ashtu edhe civile, ndikon në mundësinë e gjykatave për t'u marrë me lëndët penale brenda kohës së arsyeshme, të dhënat statistikore në këtë pjesë të raportit përfshijnë edhe lëndët civilo-juridike.

#### A. Ligji në fuqi – vendës dhe ndërkombëtar

Personi i akuzuar ka të drejtë të gjykohet brenda kohës së arsyeshme.<sup>9</sup> Kjo e drejtë është veçanërisht e rëndësishme në rastet kur personi i akuzuar gjindet në paraburgim. Duhet të theksohet se, procesi gjyqësor i shpejtë dhe ekspeditiv, shkon në interes si të palëve ashtu edhe të gjykatës, për shkak se zvarritjet shkaktojnë pasiguri juridike, rezultojnë në shfrytëzimin joefikas të resurseve të gjykatës dhe ndikojnë në aftësinë e gjykatës për zbulimin e së vërtetës.

Koha që duhet pasur parasysh për të përcaktuar nëse lënda penale ka pësuar vonesë të palejueshme, fillon të rrjedhë prej momentit kur personi i nënshtrohet akuzës dhe mbaron kur akgjykimi penal bëhet i formës së prerë. Por, megjithatë nuk është caktuar koha e saktë për të cilën mund të thuhet se përbën vonesë të paarsyetueshme. Gjatë vendosjes mbi atë se a ka pasur vonesë të paarsyeshme, duhet të merren parasysh rrethanat konkrete sikurse janë, ndërlikueshmëria e lëndës, si dhe sjelljet e të akuzuarit, autoriteteve dhe gjykatës.<sup>10</sup>

E drejta për t'u gjykuar në kohë të arsyeshme është e drejtë e mbrojtur shprehimisht sipas ligjit në fuqi.<sup>11</sup> Ligji përcakton kufizime kohore me të cilat rregullohen afatet e lejuara përgjatë fazave të ndryshme të procedurës.<sup>12</sup> Për shembull, ligji në fuqi thekson se seanca kryesore duhet të caktohet për t'u mbajtur brenda dy muajve nga data e ngritjes së aktakuzës, ose nëse kundër saj është paraqitur prapësimi, atëherë sa më shpejtë që është e mundur.<sup>13</sup> Më tej, pasi të fillojë seanca kryesore, ajo mund të shtyhet vetëm në pajtim me kushtet e parapara dhe kjo shtyreje nuk mund të zgjasë më tepër se një muaj (përndryshe gjykimi duhet të përsëritet).<sup>14</sup>

Për sigurimin e pjesëmarrjes së të akuzuarit,<sup>15</sup> dhe dëshmitarëve<sup>16</sup> në gjykim, ligji në fuqi i lejon gjykatës të marrë masa të caktuara. Këto masa japin mundësinë e shqiptimit të urdhërit për policinë që të akuzuarin ose dëshmitarin ta sjellin detyrimisht në gjykatë.<sup>17</sup>

<sup>9</sup> Neni 14(3)(c) Konventa ndërkombëtare për të drejtat civile dhe politike (ICCPR) dhe neni 6(1) i Konventës evropiane për të drejtat e njeriut (ECHR).

<sup>10</sup> *König kundër Republikës Federale të Gjermanisë*, Gjykata evropiane për të drejtat e njeriut, 28 qershor 1978 para. 99.

<sup>11</sup> Neni 14 dhe 292(2) LPP-së, Gazeta Zyrtare SFRJ, nr. 26/86 (LPP RFJ).

<sup>12</sup> Neni 174(2), 279(2) dhe 356(1) LPP RFJ.

<sup>13</sup> Neni 279 LPP RFJ. Nëse nuk caktohet datat e mbajtjes së seancës kryesore brenda kësaj periudhe, kryetari i trupit gjykues e njofton kryetarin e gjykatës i cili i ndërmer masat e nevojshme për caktimin e datës së gjykimit.

<sup>14</sup> Neni 305(3) LPP RFJ.

<sup>15</sup> Masat të cilat mund t'i marr gjykata për sigurimin e pranisë së të akuzuarit gjatë gjykimit janë: thirrja e të akuzuarit, sjellja e tij në gjykatë me ndihmën e policisë, të caktojë kaucionin për të akuzuarin, që ta lirojë




## B. Gjetjet

Gjatë procesit të monitorimit të gjykatave komunale, është vërejtur se problemi kryesor lidhur me administrimin e drejtësisë ishte pamundësia e gjykatave të merreshin me numrin e lëndëve të paraqitura dhe vonesat gjegjëse. Për shembull, të dhënat statistikore lidhur me lëndët penale, tregojnë se nga 2,894 lëndë të përfunduara gjatë pjesës së parë të vitit 2003, 56% prej tyre kishin përfunduar brenda 6 muajve nga data kur është caktuar kryetari i trupit gjykues, ndërsa për 27% të lëndëve është nevojitur më shumë se 12 muaj për t'u përfunduar.<sup>18</sup>

Shumë prej lëndëve penale të proceduara nga gjykatat komunale kanë pasur të bëjnë me vepra të lehta penale dhe kanë mundur të kryeshin në procedurë të shpejtuar. Mirëpo vonesat dhe shtyerjet që ndodhin mjaft shpesh në këto raste mund të rezultojnë në mos respektim të të drejtës së të akuzuarit për t'u gjykuar brenda kohës së arsyeshme.

Duket se në shumicën e gjykatave komunale, numri i lëndëve vetëm sa rritet. Në vitin 2003 në procedim e sipër ishin hiq më pak se 249,695 lëndë civile dhe penale nëpër këto gjykata; prej tyre 187,982 ishin paraqitur gjatë atij viti, ndërsa 61,713 ishin trashëguar nga viti paraprak. Gjatë vitit 2003 gjykatat i kishin kryer 167,795 lëndë. Këto të dhëna statistikore demonstrojnë se numri i lëndëve të zgjidhura ishte më i vogël se ato të inicuar gjatë vitit 2003, gjë që ka rezultuar në rritjen e numrit të lëndëve dhe kalimin e një numri edhe më të madh të lëndëve në vitin 2004<sup>19</sup> (shih tabelën më poshtë).



të akuzuarin të mbrohet në liri, dhe nëse ekziston rreziku se i akuzuari mund të jetë i paarritshëm për organet e drejtësisë, ta mbajë në paraburgim (nenet 183 – 191 LPP RFJ).

<sup>16</sup> Në lidhje me detyrën e dëshmitarëve të paraqiten në gjykatë gjatë seancës kryesore, shih nenin 303 të LPP RFJ. Masa të ngajshme mund të merren për të siguruar praninë e dëshmitarit edhe gjatë fazës hetimore të procedurës, shih nenin 230 dhe 237 LPP RFJ.

<sup>17</sup> Nenet 184 dhe 303 LPP RFJ.

<sup>18</sup> Kontribut i Departamentit të Administratës Gjyqësore, Ministrisë së Shërbimeve Publike.

<sup>19</sup> Gjatë vitit 2002, 190,083 lëndë ishin në procedurë; gjatë të njëjtit vit, gjykatat i kishin zgjidhur 127,913 lëndë. Prej tyre, 33,538 lëndë ishin trashëguar nga viti 2001 përderisa 156,545 ishin paraqitur gjatë atij viti. Dallim në mes të numrit të trashëguar nga viti 2001 në vitin 2002, dhe numri i lëndëve të kaluara nga viti 2003 në vitin 2004 tregon se gjatë dy viteve, numri i përgjithshëm i lëndëve në gjykata komunale është rritur për 143%.

## 1. Shkaqet organizative të vonesave (shtyrjeve)

Vonesat pjesërisht shkaktohen edhe nga aspektet organizative të sistemit gjyqësor komunal. Kjo pjesë tenton të identifikojë këto probleme organizative si dhe pasojat që ato mund të kenë në të drejtën për gjykim të drejtë.

### *i. Numri i gjyqtarëve nëpër gjykatat komunale*

Faktori i parë që duhet pasur parasysh është numri dhe shpërndarja e gjyqtarëve të angazhuar. Shumë prej gjyqtarëve të intervistuar kanë sugjeruar se arsyeja e numrit të madh të lëndëve të pazgjidhura është numri i vogël i të punësuarve nëpër gjykata. Krahasuar me vitin 1989<sup>20</sup> tani ekziston një zbritje e numrit të përgjithshëm të posteve prej 21% - pra, prej 209 në vitin 1989<sup>21</sup> në 165 në vitin 2003<sup>22</sup> (Tabela 1, Shtojca 1).

**Numri i gjyqtarëve në vitin 1989 dhe 2003**

Numri i posteve (vendeve) në 1989	Numri i posteve në 2003	Numri i gjyqtarëve në 2003
<b>209</b>	<b>165</b>	<b>128</b>

Kur kemi parasysh numrin e tanishëm të gjyqtarëve të angazhuar, duhet pasur parasysh edhe numrin e vendeve të lira të punës. Në vitin 2003, 37 poste kanë qenë të lira, që nënkuptonte se numri i gjyqtarëve ishte në të vërtetë 128<sup>23</sup>. Me përafërsisht një të pestën e posteve të lira, norma e lëndëve për gjyqtarët e mbetur në mënyrë të paevitueshme është më e lartë.

Punësimi i gjyqtarëve për të plotësuar vendet e lira padyshim do t'ju ndihmonte gjykatave ta procedojnë ngarkesën e punës. Mirëpo, siç do të shihet më poshtë, efikasiteti më i madh mund të arrihet edhe me numrin dhe sistematizimin e tanishëm të gjyqtarëve të angazhuar.

<sup>20</sup> Në vitin 1989 regjimi i Millosheviqit e kishte zhveshur Kosovën nga statusi i autonomisë brenda Republikës së Serbisë dhe si rrjedhojë, shumë gjyqtarë dhe prokurorë shqiptarë të Kosovës i kishin braktisur organet e judikaturës.

<sup>21</sup> Raporti vjetor i punës së gjykatave në vitin 1989, i publikuar nga Sekretariati krahinor i judikaturës dhe administratës së përgjithshme. Megjithatë, sipas Departamentit për Administratën Gjyqësore, Ministria e Shërbimeve Publike, vetëm 185 gjyqtarë ishin të punësuar më 1989 dhe 24 vende (poste) mbetën të hapura.

<sup>22</sup> Kontribut i Sektorit për zhvillimi profesional, Departamenti i Drejtësisë. Duhet të vërehet se rritja e numrin të gjyqtarëve është shpërndarë anëmbanë Kosovës duke pasur parasysh ndryshimet pas luftës të popullatës nëpër komuna të caktuara (numri i popullatës i cili shfrytëzohet në këtë raport, bazohet në numrin e vlerësuar që është dhënë nga Misioni i OSBE-së në Kosovë – profilet komunale). Por këtu ka edhe disa përjashtime: Gjykata Komunale e Prishtinës/Priština i ka pasur 32 gjyqtarë në vitin 1989, dhe tani i ka vetëm 28 gjyqtarë përkundër faktit se numri i popullatës në Prishtinë/Priština's vlersohet të jetë dyfishuar që nga lufta e këndej (vlerësohet se Prishtina/Priština përbëhej nga 225,388 banorë gjatë vitit 1998 ndërsa 564,800 në vitin 2002). Gjykatat tjera komunale të cilat kanë pësuar një rënje të konsiderueshme të numrit të gjyqtarëve janë Gjykata Komunale e Mitrovicës/Mitrovica me 47% rëmje dhe e Prizrenit, Suharekës/Suha Reka me 38% rënje secila nga këto.

<sup>23</sup> Kontribut i Departamentit të Administratës Gjyqësore, Ministrisë së Shërbimeve Publike. Megjithatë duhet të përmendet se sipas Këshillit Prokurorial dhe Gjyqësor të Kosovës, në vitin 2003, 137 gjykatës të gjykatave komunale ishin të punësuar përderisa 28 poste mbetën të hapura. Këta numra, edhe pse të ndryshëm, nuk influencojnë konkluzionet e Raportit.

## *ii. Efikasiteti i gjykatave*

### *Numri i lëndëve për një gjykatë*

Ekzaminimi i numrit të lëndëve për një gjykatë e ndriçon efikasitetin relativ të gjykatave të ndryshme komunale. Pjestimi i numrit të lëndëve të zgjidhura me numrin e lëndëve të pranuar nëpër secilën gjykatë, ofron një indikator të mirë të aftësisë së gjykatave për t'u marrë me numrin e lëndëve (Tabela 2 dhe 3, Shtojca 2).

Numri i lëndëve të pranuar dhe atyre të zgjidhura dallon dukshëm prej një gjykate në tjetrën. Në njërin anë, numri më i madh i lëndëve në procedurë e sipër mund të gjindet në Gjykatën Komunale të Prishtinës/Priština (e cila në vitin 2003 i kishte 44,459 lëndë) dhe Gjykatën Komunale të Pejës/Peć (që i kishte 35,864 lëndë në vitin 2003). Gjithashtu është e dukshme se këto gjykata kishin kapacitet më të ulët për zgjidhjen e lëndëve (në krahasim me të tjerat) dhe i takonin grupit prej nëntë gjykatave me një kapacitet më të ulët se 90%. Përveq këtyre dy gjykatave, në këtë grup hyjnë të gjitha gjykatat tjera komunale të qyteteve kryesore të regjioneve.<sup>24</sup> Në anën tjetër, tetë gjykata kishin një kapacitet mjaft të lartë dhe i kanë zgjidhur 98 apo më shumë përqind të lëndëve të paraqitura, përshirë këtu edhe katër gjykata të cilat kanë zgjidhur më shumë lëndë se që kanë pranuar gjatë kësaj periudhe (Tabela 3, Shtojca 2).

Gjatë vitit 2002 numri më i madh i lëndëve në procedurë është parë në Gjykatën Komunale të Pejës/Peć (me 34,266 lëndë), dhe atë të Prishtinës/Priština (me 28,021 lëndë). Në këto gjykata, vërehet dukshëm një kapacitet krahasimor më i ultë i kryerjes së numrit të lëndëve gjatë vitit 2002. Në Pejës/Peć, gjykata komunale i ka zgjidhur vetëm 66% të numrit të lëndëve të pranuar gjatë vitit 2002, ndërsa në Prishtinë/Priština, ky numër ishte 68%. Për dallim nga kjo, gjashtë gjykata të këtij lloji dhe më të vogla për nga kapacitetet, i kanë zgjidhur 97 apo më shumë përqind të numrit të lëndëve të pranuar në vitin 2002. Prej këtyre, dy gjykata i kanë zgjidhur përafërsisht 100% të lëndëve të pranuar (Tabela 2, Shtojca 2).

Prandaj kapaciteti i gjykatës për zgjidhjen e lëndëve për aq shpejtë sa edhe paraqiten ato nëpër gjykata, dallon mjaft prej njëres komunë në tjetrën dhe sillet prej 66% në përafërsisht 100% për vitin 2002. Të dhënat statistikore për vitin 2003 shënojnë një përmirësim të përgjithshëm të kapacitetit të gjykatave (mesatarisht prej 82% në vitin 2002 në 89% në vitin 2003).

### *Numri i lëndëve për një gjyqtar*

Për të vlerësuar efikasitetin e një gjykate individuale, është me rëndësi të merret në konsideratë mesatarja e numrit të lëndëve për një gjyqtar. Mirëpo, për shkak se raste të caktuara kërkojnë edhe angazhim dukshëm më të madh në punë, janë marrë parasysh vetëm lëndët komplekse në paraqitjen e këtij krahasimi. Si raste të komplikuar janë konsideruar hetimet (procedura hetimore), lëndët penale, lëndët me të miturit, lëndët civile, trashëgimore dhe jashtkontestimore<sup>25</sup> (Tabela 8 dhe 9, Shtojca 5).

Ka diskrepancë të konsiderueshme në mes të numrin të lëndëve të proceduara nëpër regionet e ndryshme, sikur kur është fjala për numrin e lëndëve të pazgjidhura dhe ato të zgjidhura. Kur

<sup>24</sup> Pra, Gjykata Komunale e Gjiçanit/Gnjilane, Prizrenit dhe Mitrovicës/Mitrovica. Katër gjykatat tjera me kapacitet nën 90% janë Gjykata Komunale e Gjakovës/Đakovica, Istogut/Istok, Ferizajit/Uroševac, dhe Kaçanikut/Kaçanik. Gjykatat komunale të Leposaviqit/Leposavić dhe Zubin Potok/ut nuk janë përfshirë në këtë krahasim.

<sup>25</sup> Ndarja në lëndë të komplekse dhe jo të komplekse i përmbahet ndarjes statistikore të bërë nga ana e Ministrisë së Shërbimeve Publike, Departamenti i Administratës Gjyqësore.

është fjala për lëndët e pazgjidhura gjatë vitit 2003, shtatë gjykata i kanë pranuar përmbi 300 lëndë për një gjyqtar, kur është fjala te maksimumi më i lartë; ndërsa kur është fjala te minimumi, shtatë gjykata i kanë pranuar më pak se 150 lëndë për një gjyqtar. Numri i lëndëve sillet prej 62.8 për një gjyqtar në Gjykatën Komunale të Dragashit/Dragaš, deri në 398.3 në Gjykatën Komunale të Gjilanit/Gnjilane dhe 424.3 në atë të Gjakovës/Đakovica.<sup>26</sup>

Në lidhje me numrin e lëndëve të zgjidhura gjatë vitit 2003, përkritazi me maksimumin më të lartë, katër gjykata i kanë zgjidhur 250 apo më shumë lëndë për një gjyqtar, ndërsa te minimumi më i ultë, tetë gjykata i kanë zgjidhur më pak se 150 lëndë për një gjyqtar.<sup>27</sup>

Nga kjo del se ekziston një diferencë e ngurtë e numrit të lëndëve komplekse që u ndahen gjyqtarëve nëpër gjykata të ndryshme. Kjo mund të adresohet përmes një sistemi tjetër të caktimit të lëndëve për gjyqtarë. Misioni i OSBE-së në Kosovë ka raportuar mbi debalancin e numrit të lëndëve për gjyqtarë të gjykatave komunale, duke rekomanduar që emërimi i gjyqtarëve të bëhet në pajtim me mesataren e numrit të lëndëve, duke pas parasyshë numrin ekzistues të lëndëve të pazgjidhura nëpër gjykata.<sup>28</sup>

Gjithashtu duket se ekziston një diferencë e konsiderueshme e numrit të lëndëve komplekse për një gjyqtar, nëpër gjykata të ndryshme. Prandaj duhet të identifikohet “praktika më e mirë” dhe të zbatohet në të gjitha gjykatat dhe nga të gjithë gjyqtarët.

### *iii. Lëndët për ekzekutim*

Gjykatat komunale gjatë vitit 2003 i kanë pranuar gjithsejt 187,982 lëndë. Në mesin e tyre, 16,068 lëndë ishin paraqitur për procedurën e përmbartimit duke përbërë kategorinë e dytë për nga madhësia menjëherë pas kategorisë “lëndët tjera”<sup>29</sup>

Përmbartimi është vendim gjyqësor i cili e ka për qëllim sigurimin e sanksionit penal apo atij civilo-juridik. Këto janë lëndë të cilat mund të kryhen shpejtë për shkak të natyrës së tyre më shumë administrative dhe nuk kërkojnë vlerësim të hollësishëm të fakteve. Por, megjithatë një studim i numrit të lëndëve të zgjidhura në vitin 2002 në raport me numrin e lëndëve të pranuar, tregon se gjykatat komunale i kanë zgjidhur vetëm 17% të lëndëve të pranuar për përmbartim. Në vitin 2003 gjykatat i kanë zgjidhur një numër dukshëm më të madh të lëndëve përmbartuese, gjegjësisht, 48% të lëndëve civile përmbartuese dhe 58% të lëndëve penale.

Prandaj, përkundër përmirësimit krahasuar me vitin 2002, përqindja e lëndëve të përmbartuara mbetet e ultë gjatë gjithë vitit 2003. Kjo, për gjykatat, mund të jetë njëra prej burimeve kryesore të rritjes së numrit të lëndëve të pazgjidhura.

---

<sup>26</sup> Efektiviteti relativ i Gjykatave Komunale në Dragash/Dragas, Gjilan/Gnjilane, dhe Gjakovë/Đakovica për vitin 2003 ishte 104%, 75% respektivisht 52%.


<sup>27</sup> Zhvillimet e paraqitura në të dhënat statistikore nga viti 2002 duket të jenë të ngjajshme. Vlerat e larta dhe të ulta mund të gjinden në gjykatat komunale të Dragashit/Dragaš, me një numër lëndësh prej 69.6 dhe 68.4 të zgjidhura për një gjyqtar dhe në Gjakovë/Đakovica me numrin e lëndëve të zgjidhura prej 595.6 syresh dhe 319 të zgjidhura për një gjyqtar.

<sup>28</sup> Shiko Raporti i Misionit të OSBE-së në Kosovë – Shqyrtimi i tretë i sistemit penal-juridik të titulluar “Shqyrtimi i sistemit penal-juridik të Kosovës”, tetor 2001, faqe 69.

<sup>29</sup> Kategoria “lëndët tjera” që përfshin rastet siq janë vërtetimi i kontratave, i nënshkrimeve etj. llogaritet për 131,487 të rasteve të pranuar gjatë vitit 2003.

#### iv. Lëndët me të miturit

Lëndët që kanë të bëjnë me kryesit e mitur, d.m.th, kryesit të cilët ende nuk i kanë mbushur 18 vjet në kohën e kryerjes së veprës penale, kryesisht procedohen (për to janë kompetente) nga gjykatat komunale. Për të miturit është e paraparë procedura e veçantë gjyqësore të cilën e kryeson i ashtuquajtimi gjyqtarë për të mitur<sup>30</sup>. Janë shtatë gjykata komunale të cilat merren me rastet për të mitur, secila me nga një gjyqtarë për të mitur (tabela në vijim dhe Shtojca 4).



Duhet të vërehet se numri i lëndëve të pranuar dhe të zgjidhura dallon nëpër gjykatat për të mitur. Gjatë vitit 2003, Gjykata Komunale e Prizrenit i ka pranuar 299 lëndë, tre herë më shumë se Gjykata Komunale e Pejës/Peç, e cila i ka pranuar vetëm 89 raste. Dallime të ngjajshme vërehen edhe gjatë vitit 2002, kur Gjykata Komunale e Prizrenit i ka pranuar 231, ndërsa ajo e Gjakovës/Đakovica vetëm 67 lëndë. Në përgjithësi numri i lëndëve për të mitur është rritur prej 995 në vitin 2002, në 1178 në vitin 2003 (Tabela 6 dhe 7, Shtojca 4).

Një diskrepancë e ngjajshme mund të vërehet edhe për numrin e lëndëve të zgjidhura. Gjykata Komunale në Prizren i ka zgjidhur 209 lëndë, tre herë më shumë se ajo e Gjakovës/Đakovica e cila i ka zgjidhur 56.

Numri i lëndëve të zgjidhura për të mitur meriton një vëmendje të posaçme për shkak se gjykatat i kanë zgjidhur vetëm përafërsisht gjysmën ose më pak të lëndëve të pranuar gjatë vitit 2002. Kjo është shqetësuese për shkak se ekziston nevojë e posaçme për t'i proceduar lëndët në mënyrë të ngutshme për qëllim të zvogëlimit të pasojave negative të cilat mund të shkaktohen për të miturit në procedurë. Në vitin 2003, numri i lëndëve të zgjidhura është rritur si në numrin relativ poashtu edhe në atë absolut të lëndëve. Mirëpo, për shkak se numri i lëndëve të pranuar shtohet çdo herë e më shumë, numri i lëndëve të bartura në vitin 2004 ishte edhe më i madh se sa ai i lëndëve të bartura nga viti 2002. (Tabela 7, Shtojca 4).

<sup>30</sup> Neni 452-492 LPP FRJ.

## 2. Vonesat gjatë procedurës së gjykimit

### *i. Mos respektimi i afateve ligjore*

Misioni i OSBE-së në Kosovë, më heret ka raportuar për mungesën e koordinimit dhe menagjimit të fluksit të lëndëve në instancën e gjykatave të qarkut<sup>31</sup> Monitorimi i gjykatave komunale ka paralajmëruar për probleme të ngjajshme të cilat shkaktojnë zvarritje të gjata.

Si rregull e përgjithshme, data e mbajtjes së seancës së parë të shqyrtimit kryesor duhet të caktohet brenda dy muajve nga ngritja e aktakuzës.<sup>32</sup> Misioni i OSBE-së në Kosovë i ka monitoruar raste të shumta kur ky afat kohor është tejkaluar dukshëm. Disa prej shembujve janë paraqitur në vijim:

Në një rast pranë Gjykatës Komunale në Pejë/Peć, aktakuza është ngritur në maj të vitit 2002, ndërsa seanca kryesore nuk është caktuar deri në qershor 2003, 13 muaj më vonë. Kur është mbajtur seanca kryesore për këtë rast jo aq të komplikuar, ajo zgjati vetëm gjysmë ore. Gjykimi u mbajt me 25 qershor 2003 dhe i akuzuari ishte shpallur fajtor sipas akuzave për tregëti të kundërligjshme dhe i ishte caktuar denimi prej gjashtë muajsh heqje lirie me kusht për një vjet.

Në një rast tjetër pranë Gjykatës Komunale në Pejë/Peć, në të cilin i akuzuari ishte akuzuar për falsifikim të dokumenteve, të njëjtat çështje janë ngritur. Aktakuza është ngritur në janar të vitit 2002, por dita e sancës së parë të shqyrtimit kryesor nuk është caktuar deri me 20 qershor 2003, pra 18 muaj më vonë. I akuzuari pas thirrjes për seancë kryesore nuk u paraqit dhe si pasojë doli edhe një shtyerje për shkak se gjykata urdhëroi sjelljen e detyruar (me forcë) të të akzuarit.

Në një rast tjetër me akuzë të falsifikimit, pranë Gjykatës Komunale në Kaçanik/Kaçanik, aktakuza ishte ngritur në janar të vitit 2002, mirëpo data e seancës kryesore ishte caktuar tek në korrik të vitit 2003, pra 17 muaj më vonë.

Në një rast pranë Gjykatës Komunale në Gjilan/Gnjilane, një person akuzohej për falsifikim të dokumenteve. Aktakuza ishte ngritur në shtator të vitit 2000, ndërsa thirrjet e para për paraqitje në gjykatë ishin bërë tek kah mesi i tetori 2001. Kryetari i trupit gjykues nuk kishte urdhëruar arrestimin e të akzuarit deri para qershorit të vitit 2003.

Misioni i OSBE-së në Kosovë i ka monitoruar një numër rastesh tjera të cilat kishin zvarritje të ngjajshme. Shkalla e rasteve të përcjellura sugjeron të ketë një mos respektim të rregullt të afateve ligjore. Shprehja e këtij niveli të vonesave të pajustificueshme mund të rezultojë në shkelje të të drejtës së të akzuarit për gjykim brenda kohës së arsyeshme.

### *ii. Sigurimi i pjesëmarrjes së të akzuarit dhe dëshmitarëve në procedurë*

Një prej arsyeve kryesore të vonesave në procedurën penale janë vështirësitë e hasura në sigurimin e prezencës së të akzuarve, dëshmitarëve dhe palëve të dëmtuara në gjykim. Prej rasteve të monitoruara nga Misionin i OSBE-së në Kosovë, të cilat ishin shtyer, më shumë se një

<sup>31</sup> Misioni i OSBE-së në Kosovë, Departamenti i të drejtave të njeriut dhe sundimit të së drejtës, Raporti nr 9 mbi Administrimin e drejtësisë, mars 2002.

<sup>32</sup> Neni 279 LPP RFJ.

e treta e tyre ishin shtyer për shkak të mungesës së të akuzuarit, prokurorit ose dëshmitarëve. Në shumicën më të madhe të këtyre rasteve ka munguar i akuzuari. Në disa raste janë nevojitur disa shtyerje të njëpasnjëshme para se të sigurohej prania e tij/saj në gjykatë.

Dy raste të këtilla janë vërejtur në Gjykatën Komunale të Prishtinës/Priština. Në rastin e parë, i akzuarit ngarkohej se ka kryer veprën penale të shkakimit të rrezikut të përgjithshëm në dhjetor të vitit 2000. Aktakuza është ngritur me 7 shkurt 2001, dhe me 30 qershor 2003, edhe pas shtatë thirrjeve i akuzuari ende nuk ishte paraqitur në gjykatë.

Në rastin e dytë, tre të pandehur ishin akuzuar se i janë kërcënuar dikujt me një mjet të rrezikshëm gjatë një grindje si dhe për posedim ilegal të armëve ose lëndëve shpërthyes. Me 10 korrik 2003, ky rast ishte shtyer për të pestën herë për shkak të mospjesmarrjes së të akuzuarit. Kah fundi i vitit 2003, të dyja këto raste ishin ende të pazgjidhura dhe asnjë veprim nuk ishte ndërmarrë që nga korriku i vitit 2003.

Në tre raste në Gjykatën Komunale të Kaçanikut/Kaçanik, personat e akuzuar përballeshin me akuzat për vjedhje të pyllit dhe ishin thirrur 8, 9 respektivisht 13 herë. Kryetari i trupit gjykues atëherë vendosi që të lëshojë urdhërin për sjelljen e tyre nga ana e policisë. Të tri rastet kishin rezultuar në vonesa serioze.

Duket se ekzistojnë probleme të shumfishta lidhur me sistemin e thirrjeve gjyqësore.<sup>33</sup> Problemi i parë për gjykatat është të vërtetohet adresa e saktë. Shpesh, të dhënat e paraqitura në shkresat e lëndës nuk përfshijnë edhe vendbanimin e saktë të personit të akuzuar ose dëshmitarit. Por edhe atëherë kur të konstatohet adresa e saktë, ekzistojnë problemet lidhur me gjetjen e vendit. Gjatë disa viteve të fundit janë ndërruar emrat e rrugëve, vendbanimeve etj, duke vështirësuar edhe më tej punën e personelit gjyqësor, por edhe të policisë në gjetjen e adresave të duhura. Puna lidhur me gjetjen e dëshmitarëve dhe të akuzuarve merr mjaft kohë për t'u kryer si për gjykatat ashtu edhe për policinë. Në kuadër të policisë ekziston Njësia regjionale për kërkesa dhe ekzekutimin e urdhërave gjyqësor (RUWC orig) e cila ka për detyrë ta dorëzojë/ekzekutojë urdhërarrestin gjyqësor.<sup>34</sup>

Për t'u marrë me këtë problem, disa gjyqtarë të gjykatave komunale dhe përfaqësues të njësimit regional të arrestimeve, kanë sugjeruar që në letërnjoftime të përfshihet edhe adresa. Për shkak se në shkresat e lëndës zakonisht është edhe kopja e letërnjoftimit të personit të akuzuar dhe dëshmitarëve, kjo do të lehtësonte punën e gjykatave për gjetjen e personit.

Një mënyrë tjetër e përmirësimit të aftësisë së gjykatave për të identifikuar dhe gjetur personat, mund të jetë përmes koordinimit më të mirë me regjistrin civil.<sup>35</sup> Urdhërsa administrative nr. 2002/16përcakton procedurën për autoritetet gjyqësore të UNMIK-ut për të kërkuar zbulimin e të

<sup>33</sup> Dorëzimi i thirrjeve nëpër rajonet e pakicave krijon probleme të veçanta. Si në Gjilan/Gnjilane ashtu edhe në Mitrovicë/Mitrovica, kryetarët e gjykatave komunale kanë vënë në pah se personeli gjyqësor nuk i dorëzon thirrjen nëpër këto rajone për shkak të gjendjes së sigurisë. Për këtë arsye në Gjilan/Gnjilane thirrjet duhet të dorëzohen përmes postës nëpër pjesët ku si shumicë jetojnë serbët e Kosovës. Në Mitrovicë/Mitrovica gjykata ka arritur një marrëveshje me policinë që kjo e fundit t'i dorëzojë të gjitha letërrhjet nëpër pjesën veriore të komunës.

<sup>34</sup> Për shkak se njësia nuk është prezente në të gjitha regjionet, gjykata gjithashtu mund t'i drejtohet policisë lokale për ekzekutimin e urdhërarrestit për të akuzuarin dhe dëshmitarët të cilët nuk i janë përgjigjur thirrjes gjyqësore.

<sup>35</sup> Regjistri civil është themeluar në pajtim me Rregulloren e UNMIK-ur nr. 2000/13 mbi Regjistrin civil qendror. Në këtë regjistër hyjnë të dhënat për banorët e Kosovës, siç janë: emri, mbiemri, data e lindjes, vendi i lindjes, adresa e tanishme dhe të dhënat për prindërit (nëse ekzistojnë). Personi i regjistruar posedon me numrin e letërnjoftimit.

dhëname personale nga regjistri civil.<sup>36</sup> Kjo udhëresë thekson se kërkesa duhet të parashtrahet përmes drejtorit të Departamentit të Drejtësisë dhe t'i adresohet Drejtorisë për çështje administrative.<sup>37</sup> Në praktikë, pasi të merret autorizimi një herë, nevojiten përafërisht pesë minuta për të kërkuar.<sup>38</sup> Mirëpo, shumica e gjyqtarëve të gjykatave komunale dhe policisë nuk kanë njohuri për këtë mundësi të sigurimit të adresës së personave. Më tej, kjo procedurë edhe pse në mënyrë të qartë lejon kërkesat nga gjykatat, duket se nuk është e dizajnuar që të procedojë një numër të madh kërkesash.

### *iii. Mospjesëmarrja e prokurorëve*

Një shkas tjetër i shtyerjes është mos-pjesëmarrja e prokurorëve në seancën gjyqësore. Sipas procedurës së rregullt penale, gjykata është e obliguar që të shtyjë seancën gjyqësore në mungesë të prokurorit<sup>39</sup>. Është monitoruar një numër i seancave gjyqësore ku prokurori nuk kishte marrë pjesë në to.

Seanca gjyqësore e caktuar që të mbahet më 1 korrik të vitit 2003 në Gjykatën Komunale të Gllgovcit/Glogovac, që kishte të bëjë me katër të akuzuar për vepra penale të fshehjes përkitazi me vjedhje të përbashkët, ishte shtyrë për arsye se prokurori nuk kishte qenë prezent. Gjyqtari kryesor nuk i kishte paraqitur shkaqet se përse prokurori nuk kishte qenë prezent në seancën dëgjimore.

Në një seancë gjyqësore të mbajtur më 27 qershor 2003 në Gjykatën Komunale të Gjilanit/Gnjilane, që përfshinte dy persona të akuzuar që ishin të ngarkuar me veprën se ata kishin parandaluar personin zyrtar që t'i kryejë detyrat e tij, prokurori ishte larguar nga seanca për shkak të një thirrjeje urgjente. Për shkak të mungesës së prokurorit, seanca ishte ndërprerë dhe ishte shtyrë gjer në një datë të pacaktuar.

Janë vëzhguar një numër i konsiderueshëm i rasteve të tilla. Njëra prej arsyeve për mungesën e ko-ordinimit në mes gjykatave dhe prokurorëve mund të jetë fakti se prokurorët janë caktuar nëpër gjykata komunale të qyteteve më të mëdha rajonale dhe jo nëpër gjykata përkatëse komunale nëpër të cilat ata punojnë<sup>40</sup>. Shumica e kryetarëve të gjykatave kanë theksuar se më mirë është që prokurorët të caktohen drejtpërdrejt në gjykatën e posaçme komunale, se sa të udhëtojnë nëpër rajon. Një ndërrim i tillë mund të përmirësojë ko-ordinimin në mes gjykatave me prokurorët. Kjo mund të jetë veqanërisht e rëndësishme kur prokurorët të marrin përgjegjësi të reja sipas kodit të përkohshëm të procedurës penale.<sup>41</sup>

<sup>36</sup> Urdhëresa administrative nr. 2002/16, për implementimin e Rregullores së UNMIK-ut nr. 2000/13 e ndryshuar përmes urdhëresës administrative nr. 2003/19.

<sup>37</sup> Shih nenet 3.3 dhe 3.4 të urdhëresës administrative nr. 2002/16.

<sup>38</sup> Sipas zëvendësit të sekretarit të regjistrimit civil.

<sup>39</sup> Neni 299 RFJ- së KPP.

<sup>40</sup> Si shtesë për prokurorët e Prishtinës/Prishtina, Gjilanit/Gnjilane, Mitrovicës/Mitrovica, Pejë/Pejë, and Prizrenit, është shtuar edhe në komunën e Ferizajit/Uroševac një, dhe këta mbulojnë gjykatat komunale në Ferizaj/Uroševac and Kaçanik, dhe njëri në Gjakovë/Djakovica, që e mbulon gjykatën komunale të Gjakovës/Djakovica.

<sup>41</sup> Njëra prej detyrave të caktuara për prokurorin sipas KPPP- së, është që të mbikqyrë punën e policisë gjyqësore gjatë hetuesisë dhe të mbledhë dëshmi për të filluar procedurat penale. Shih nenin 46 të ligjit të sipërpërmendur.



#### **iv. Mungesa e gjyqtarëve në Zubin Potok dhe Leposaviq/Leposavic**

Përderisa shumica e komunave ishin konsoliduar në vitin 2000, kjo nuk ka ndodhur nëpër disa komuna në pjesën veriore të rajonit të Mitrovicës/Mitrovica.<sup>42</sup> Sidoqoftë, duke u referuar në deklaratën e përbashkët të Ministrit të Drejtësisë së Serbisë dhe Zv./ PSSP për polici dhe drejtësi të UNMIK- ut, në korrik të vitit 2002 UNMIK- u ka vendosur që të hapë dy gjykata komunale në rajonin e Mitrovicës/Mitrovica, njerën në Zubin Potok dhe tjetrën në Leposaviq/Leposavic.<sup>43</sup> Këto gjykata janë hapur në janar të vitit 2003.

Fillimisht, pas hapjes së gjykatave, është caktuar një gjyqtar në gjykatën komunale në Zubin Potok dhe tre gjyqtarë tjerë në gjykatën komunale në Leposaviq/Leposavic. Sidoqoftë, për një periudhë të gjatë, vetëm një gjyqtar profesional kishte punuar në gjykatën e Leposaviqit/Leposavic. Në fund të vitit 2003, një gjyqtarë tjetër është caktuar me punë, dhe gjyqtari i tretë kishte filluar punën në fillim të vitit 2004. Dhe deri më tani asnjë gjyqtar porot nuk është caktuar në asnjërën prej këtyre gjykatave. Mungesa e gjyqtarëve ka shkaktuar vonesa në procedimin e rasteve në të dyja gjykatat.

Që nga hapja e gjykatave, që të dyja kanë pranuar raste nga Gjykata e Qarkut të Mitrovicës/Mitrovica, të cilat bijnë nën kompetencën e tyre territoriale. Në fund të vitit 2003, gjykata komunale e Leposaviqit/Leposavic ka pranuar 74 raste penale të gatshme për gjykim dhe 62 raste nën hetime. Sidoqoftë, derisa nuk është caktuar gjyqtari i tretë në pozitën e tij, në fillim të vitit 2004 gjykata nuk ka pasur kapacitet që t'ia dalë me ndonjë prej këtyre rasteve. Për momentin, gjykata mund të zhvillojë hetimet dhe mund të mirret me ato raste penale të cilat mund gjykohen nga vetëm një gjyqtar.

Gjykata Komunale e Zubin Potokut, në qershor të vitit 2003 kishte pranuar 56 raste nga Gjykata e Qarkut të Mitrovicës/Mitrovica, dhe vazhdimisht është duke pranuar raste të reja nga prokuroria. Deri më tani, gjykata ka qenë në gjendje që të përfundojë disa hetime, por sidoqoftë, gjykata nuk mund të zhvillojë seanca gjyqësore për shkak të mungesës së gjyqtarëve profesional dhe të gjyqtarëve porot.

Mungesa e gjyqtarëve profesional dhe të gjyqtarëve porot në këto dy gjykata është duke shkaktuar shtyerje dhe mund të ndikoj negativisht në të drejtën e të akuzuarit që të gjykohet në kohë të arsyeshme.

#### **C. Kodi i përkohshëm i procedurës penale i Kosovës**

Më 6 prill të vitit 2004 do të hyjë në fuqi *Kodi i përkohshëm i procedurës penale i Kosovës*<sup>44</sup>, që do ta zëvendësojë, *inter alia*, KPP të RFJ- së. Ky kod i ri reformon disa aspekte të procedurës penale. Kodi i ri i procedurës penale nuk përfshinë ndërrime të mëdha në raport me ligjin ekzisues përkitazi me të drejtën për gjykim në kohën e arsyeshme, megjithatë, janë disa ndërrime që ia vlenë t'i përmendim.

<sup>42</sup> Në vend të gjykatave paralele që kanë funksionuar në rajonin e Mitrovicës/Mitrovica. Shih raportin e OMIK- ut mbi *strukturat paralele në Kosovë, tetor 2003*, fq. 17.

<sup>43</sup> Këto dy gjykata janë themeluar si pjesë e mëtimit që të ndalohen strukturat paralele nëpër disa rajone specifike ku jetojnë serbët dhe të themelojnë gjykata të atilla që janë nën ambrellën e sistemit gjyqësor të UNMIK- ut. Për detaje të hollësishme për situatën e tanishme dhe të historisë të sistemit të gjykatave paralele, shih raportin e OMIK- ut mbi *strukturat paralele në Kosovë, tetor 2003*, fq. 17.

<sup>44</sup> Në të njëjtën ditë hynë në fuqi edhe rregullorja e UNMIK- ut mbi kodin e përkohshëm të procedurës penale të Kosovës.

Masat të cilat gjykata mund t'i ndërmerrë për të siguruar prezencën e të akuzuarit përfshijnë edhe ato masa që parashihen në ligjin e KPP të RFJ- së<sup>45</sup>. Si shtesë në këto, kodi i ri siguron që gjykatat mund të urdhërojnë të akuzuarin që të paraqitet në periudha të caktuara në stacionin policor ose të mbahet në paraburgim shtëpiak.<sup>46</sup> Kur kemi të bëjmë me thirrjen e dëshmitarëve, kodi i ri i lejon gjykatës që të detyrojë dëshmitarin që të paraqitet para gjykatës nëse ai/ ajo nuk prezenton arsyetimin për mosparaqitjen në thirrjen që iu është bërë më parë.<sup>47</sup> Në këtë rast, gjykata mundet edhe ta dënojë me gjobë dëshmitarin.<sup>48</sup>

#### **D. Konkluzion**

Është e pakundërshtueshme se vonesat në rastet e procesuara dhe rritja e punëve të pakryera mund të ketë efekt negativ në administrimin e drejtësisë në raport me çështjet penale, e poashtu edhe me ato civile. Rritja e lëndëve të pakryera duhet që urgjentisht të adresohet para se të fillojë të bëhet vetë burim shtesë i vonesave. Efikasitet më i madh mund të arrihet duke identifikuar praktikatat e mira në gjykatat me nivel më të lartë të efikasitetit, dhe që këto mëpastaj të aplikohen në tërë Kosovën. Si shtesë, duhet të plotësohen postet e lira, dhe ku është e domosdoshme, gjyqtarët përsëri të ri-shpërndahen nëpër gjykata.

Në vitin 2003, Këshilli Gjyqësor dhe Prokurorial i Kosovës e ka bërë vlerësimin e Sistemit Gjyqësor, i cili është ndërmarrë në bashkëpunim me Sektorin e Zhvillimit Gjyqësor pranë Departamentit të Drejtësisë së UNMIK- ut, zyrën e Departamentit të Drejtësisë së SHBA- ve për Zhvillimin Tejoqeanik të Shërbimeve Prokuroriale, Ndihmë dhe Trajnim, dhe Këshillin e Evropës. Projekti ka vlerësuar strukturën e tanishme të gjykatave në Kosovë, përfshirë këtu edhe vlerësimin e numrit të kërkuar të posteve gjyqësore dhe prokuroriale. Rezultatet do të prezentohen në një raport të ardhshëm.

---

<sup>45</sup> Do të thotë thirrjet, urdhëresa për arrestim, premtimi se i akuzuari nuk do të braktisë vendbanimin dhe dorëzania. Shih nenin 268 të KPPP.

<sup>46</sup> Nenet 268, 273 dhe 278 të KPPP.

<sup>47</sup> Neni 343 KPPP.

<sup>48</sup> Neni 167 i Kodit të përkohshëm të procedurës penale

## PJESA 3

### E DREJTA E GJYKIMIT NGA TRIBUNALI I THEMELUAR ME LIGJ

E drejta për një gjykim të drejtë përfshinë edhe kërkesat që tribunali të themelohet me ligj dhe të funksionojë në përputhje me ligjin.

#### A. Ligji në fuqi – vendës dhe ndërkombëtar

E drejta për një gjykim të drejtë përfshinë të drejtën për t'u gjykuar nga tribunali i themeluar me ligj.<sup>49</sup> Në vazhdimësi të kësaj kërrese, Gjykata europiane për të drejtat e njeriut (Gjykata europiane) ishte e qëndrimit se gjykata, si shtesë, duhet të përbëhet në mënyrë të rregullt “*në përputhje me ligjin*” duke theksuar se kjo kërkesë është shkelur, nëse tribunali nuk funksionon në përputhje me ligjin e procedurës së zbatueshme.<sup>50</sup>

Ligji i zbatueshëm thekson se veprat penale që dënohen me maksimum pre 1 deri 15 vite heqje lirie, duhet të gjykohen nga trupi gjykues i përbërë nga një gjyqtar profesional dhe dy gjyqtarë ndihmës.<sup>51</sup> Ligji më tutje thekson se gjyqtarët duhet të jenë prezent gjatë gjykimit;<sup>52</sup> kërkohet nga kryetari i trupit gjykues të kujdeset që lënda në fjalë të ekzaminohet plotësisht<sup>53</sup> dhe anëtarët e trupit gjykues, nëpunësi i gjykatës, si dhe gjyqtari ndihmës dhe gjyqtari zëvendësues të jenë “vazhdimisht në seancën kryesore të gjykimit”.<sup>54</sup>

#### B. Gjetjet

Monitoruesit e seancave gjyqësore kanë vërejtur shkeljen e ligjit të zbatueshëm sa i përket përbërjes së trupit gjykues dhe kërkesës që gjyqtarët të mbesin vazhdimisht prezent gjatë seancës kryesore të gjykimit.

Në një seancë gjyqësore të mbajtur në gjykatën komunale të Vitisë/Vitina më 9 shtator 2003, i akuzuari ishte ngarkuar me vepër të falsifikimit të dokumenteve dhe ishte dënuar me tre muaj librim me kusht. Trupi gjykues ishte përbërë prej një gjyqtari profesional dhe me vetëm një gjyqtar ndihmës. Gjyqtari tjetër ndihmës i cili ishte caktuar për rast sipas regjistrimit në procesverbal, nuk kishte marrë pjesë. Sidomos procesverbali i seancës së dëgjimit kishte të dhëna jo të sakta se në seancë kishin marrë pjesë dy gjyqtarë të trupit gjykues.

Në një rast tjetër, këtë herë para gjykatës komunale të Kaçanikut, ishte paraqitur e njejta situatë. Gjatë seancës gjyqësore, e cila ishte mbajtur më 10 tetor të vitit 2003, kishin marrë pjesë vetëm gjyqtari profesional dhe një gjyqtar ndihmës. I akuzuari ishte ngarkuar me vepër të falsifikimit të dokumenteve dhe ishte dënuar me katër muaj dënim me kusht për një vit. Gjithashtu edhe në këtë rast procesverbali kishte qenë i shënuar në mënyrë të parregullt se gjatë seancës së gjykimit, kishin marrë pjesë dy gjyqtarë ndihmës.

<sup>49</sup> Neni 14 (1) ICCPR dhe neni 6 (1) i Konventës europiane.

<sup>50</sup> *Zand kundër Italisë*, **Raporti** i Komisionit No. 7360/76, 15 DR 70 (1978) dhe *Rossi kundër Francës* | Raporti i Komisionit No. 11879/85, 63 DR 105 (1989).

<sup>51</sup> Neni 23 i KPP të RFJ- së.

<sup>52</sup> Neni 291 i KPP të RFJ- së.

<sup>53</sup> Shih nenin 292 (2) i KPP të RFJ- së, i cili gjithashtu thekson se nëse paraqitet se seanca gjyqësore do të zgjasë dhe se gjyqtarit është e mundur që ta lënë trupin gjykues, mund të caktohen gjyqtarit zëvendësues që të marrin pjesë në seancën kryesore në mënyrë që t'i zëvendësojnë anëtarët e trupit gjykues të cilët mund të ndodhë që mos të marrin pjesë në seancën kryesore.

<sup>54</sup> Neni 291 (1) i KPP të RFJ- së.

Ky dështim që të ipet numri i saktë i gjyqtarëve ndihmës që kanë marrë pjesë në të dyja seancat gjyqësore ka shpër deri te shkelja e dispozitave të zbatueshme dhe shkeljen e të drejtës së të akuzuarit që të jetë i gjykuar nga ana e tribunalit të themeluar me ligj.

### **C. Kodi i përkohshëm i procedurës penale i Kosovës**

Duhet të ketë përputhje me dispozitat procedurale të zbatueshme, duhet që secila gjykatë të jetë në përputhje me kërkesat e “rregulluara me ligj”. Në këtë aspekt, duhet të dihet se, sipas ligjit të ri, edhe vetëm një gjykatës mund të lejohet që t’i kryej rastet e veprave penale të cilat janë të dënueshme me gjobitje, apo deri në tre vite heqje lirie.<sup>55</sup>

---

<sup>55</sup> Neni 22 (2) KPPP në krahasim me Neni 23 (1) të KPP të RFJ- së.

## PJESA 4

### E DREJTA PËR TRIBUNAL TË PAANSHËM

Çështjet e karakterit ligjor, praktik dhe struktural mund të ndikojnë në paanshmërinë e tribunalit dhe njëkohësisht në të drejtën e të akuzuarit për gjykim të drejt. Kjo pjesë mirret me çështjet e paanshmërisë që mund të ngriten në sistemin e tanishëm për shkak të përbërjes së trupit gjykues në procedurën e shkurtuar, për të mitur dhe procedurën e rigjykimit.

#### A. Ligji në fuqi – vendës dhe ndërkombëtar

Çdo person i ngarkuar me vepër penale ka të drejtë në gjykim të drejtë dhe publik nga ana e një tribunalit të paanshëm.<sup>56</sup> E drejta për tribunal të paanshëm përfshinë si kërkesat subjektive, poashtu edhe ato objektive.<sup>57</sup> Siç është paraqitur testi subjektiv duhet të të përcaktohet “*mbi baza të dënimit personal dhe sjelljes së gjyqtarit përkatës për rastin*” përdërisa testi objektiv duhet të vlerësohet mbi baza, veçmas nga sjellja e gjyqtarit, “*ka fakte konstatuese, të cilat mund të ngrisin dyshimet mbi paanshmërinë.*”<sup>58</sup> Kur të mirren parasysh faktet të cilat mund të rrisin një dyshim të tillë, çështje vendimtare është se a mundet ky dyshim të arsyetohet “*objektivisht*”.<sup>59</sup> Shih për këtë, “*paraqitjet*” ose nëse (sa i përket perspektivës së publikut) ka fakte tjera që ngrisin dyshimin e paanshmërisë së gjyqtarit, janë konsideruar të rëndësishme.<sup>60</sup>

Gjykata Europiane ka gjetur ‘dyshim legjitim’ në lidhje me paanshmërinë në rastet kur gjyqtari ka marrë pjesë në përgatitjen e rastit për gjykim.<sup>61</sup> Çështja kyçe ka qenë se a mundet që përfshirja e gjyqtarit në përgatitjen e rastit mund të konsiderohet ta ketë lenë gjyqtarin me përshtypjen e fajësisë së të akuzuarit?<sup>62</sup> (ose të ketë “shkallë të lartë të qartësisë” sa i përket kësaj çështjeje).<sup>63</sup> Sipas gjykatës, e gjetura pozitive në këtë çështje ka qenë e mjaftueshme për ti ngritur ne sytë publikut dyshimet mbi paanshmërisë së gjyqtarit në seancë. Gjykata, gjithashtu ka konsideruar se,

<sup>56</sup> Kjo e drejtë është kyçe në të drejtën e të akuzuarit për gjykim të drejt, dhe se ligji ndërkombëtar e ngarkon gjykatën me një obligim të tillë që të sigurojë se kjo e drejtë respektohet në të gjitha rastet, shih nenin 14 (1) ICCPR; neni 6 (1) i KEDNJ.

<sup>57</sup> *Ferrantelli dhe Santangelo kundër Italisë*, KEDNJ, 7 gusht 1996, para. 56- 58.

<sup>58</sup> *Ibid* para. 56-58.

<sup>59</sup> *Hauschildt kundër Danimarkës*, KEDNJ 24 maj 1989 para. 48; *Fey kundër Austrisë*, KEDNJ, 24 shkurt 1993 para. 30.

<sup>60</sup> *Hauschildt kundër Danimarkës*, 24 maj 1989 para. 48; *Fey kundër Austrisë*, 24 shkurt 1993 para. 30,

<sup>61</sup> Disa prej këtyre rasteve kanë përfshirë praktikën e themeluar vendore. Shih rastin, *De Cubber kundër Belgjikës*, 26 tetor 1984; *Pfeifer dhe Plankl kundër Austrisë*, KEDNJ, 25 shkurt 1992.

<sup>62</sup> *Fey kundër Austrisë*, 24 shkurt 1993, para. 35. Shih gjithashtu *De Cubber kundër Belgjikës*, 26 tetor 1984. para. 29, ku gjykata europiane ka gjetur se gjyqtari i seancës në fjalë ka vepruar si gjykatës hetues “*kjo është mjaft e besueshme se ai mundet, që të paraqitet para të akuzuarit, [...] dhe se ka pasur mendim të paragykuar i cili është e mjaftueshme që të vihet në peshë balansimi i çastit i vendimit. Në shtesë, gjykata penale(korrigjimi i tribunalit) mundet që, sikurse gjykata e shkallës së dytë (e apelit), [...] duhet ta rishqyrtoj ligjshmërinë e masave të ndërmarra nga ana e gjyqtarit hetues. I akuzuari mund të shikojë prospektin e gjyqtarit hetues që është i përfshirë aktivisht në këtë proces të rishqyrtimit.*”

<sup>63</sup> Shih *Hauschildt kundër Danimarkës*, 24 maj 1989 para. 52. Gjithashtu *Ferrantelli & Santangelo kundër Italisë*, 7 gusht 1996, ku gjykata ka qenë e mendimit se frika e aplikantit (të miturit), në mungesë të paanshmërisë së gjykatës për të mitur, ka qenë e arsyetueshme objektivisht. Gjyqtari i cili e ka udhëhequr një rast në gjykatën e të rriturve, dhe se njëkohësisht e ka udhëhequr gjykatën për të mitur në raport me rastin e njejtë të të pandehurit të mitur i ndjekur me të njejtën vepër, ka përdorur të njejtat argumente dhe parapercaktime dhe vlerësime të dëshmive nga njeri rast në tjetrin, kështu e ka prurë paraqitjen e tij në nivelin e anshmërisë në procedurë.

nëse gjyqtari i kryen funksionet e prokurorit gjatë seancës gjyqësore, atëherë mund të vihet në pyetje paanësia e gjykatës.<sup>64</sup>

Kështuqë, i akuzuari ka të drejtë për gjykim për të cilin nuk ekzistojnë dyshime që e vënë në pyetje paanësinë e trupit gjykues. Megjithatë, ligjet e zbatueshme vendore si dhe praktikat në Kosovë mund të mos jenë në përputhje me jurisprudencën dhe standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut. Përderisa procedura e rregullt e cila e udhëheqë procedurat tjera në gjykatën komunale në mënyrë të qartë e pengon gjyqtarin që të jetë në përbërjen e trupit gjykues nëse ai më parë i ka kryer veprimet hetuese në po të njejtin rast<sup>65</sup>, nuk ka asnjë ndalesë të tillë në procedurën e shkurtuar (sumare), në procedurën për të mitur ose në rigjykimet.

## B. Gjetjet

### 1. Procedura e shkurtuar (sumare)

Ligji i zbatueshëm e rregullon procedurën e shkurtuar (sumare) kur kemi të bëjmë me rastet penale nëpër gjykatat e shkallës së parë, për të cilat raste dënimi maksimal është ai me gjobitje ose periudha e heqjes së lirisë deri në tre vite.<sup>66</sup> Kjo procedurë është e desajnuar për të përshpejtuar kryerjen e rasteve më të lehta.<sup>67</sup> Zbatimi i procedurës së shkurtuar në rastet më të lehta është përdorur në shumë vende për të përshpejtuar gjykimet. Sidoqoftë, një procedurë e tillë duhet që mos të lejohet që të ketë efekt kundërshtues në të drejtat themelore procedurale të të akzuarit.

i. Sa i përket përbërjes së trupit gjykues ligji mbi procedurën e shkurtuar thekson që “një gjykatës i cili ka kryer veprimet hetuese nuk është i diskualifikuar nga pjesëmarrja në seancën kryesore gjyqësore në cilësinë e kryetarit të trupit gjykues ose si anëtar i trupit gjykues”<sup>68</sup> Një përfshirje e tillë në rast mund ta vëjë në pyetje paanësinë e gjyqtarit. Mund të vërehet se kjo dispozitë i shmaget rregullave të përgjithshme të diskualifikimit të gjyqtarit siç theksohet tjetërkund në ligjin procedural.

ii. Dhe më tutje, ligji i zbatueshëm në procedurat sumare lejon që gjykimi të vazhdojë edhe kur prokurori publik nuk merrë pjesë, përkundër njoftimit që iu është bërë.<sup>69</sup>

Në gjykatën komunale të Pejës/Pec një person ishte gjykuar për vetë- gjyqësi të palejueshme, dhe më 27 gusht 2003, ishte dënuar me katër muaj heqje lirie (dënim me kusht). Edhe pse ishin mbajtur dy seanca gjyqësore, prokurori nuk kishte qenë prezent për asnjë moment gjatë gjykimit.

Në një rast para gjykatës komunale në Gjilan/Gnjilane, më 11 shtator 2003, prokurori kishte munguar gjatë tërë procedurës. Në këtë rast të akzuarit iu ishte shqiptuar dënim i për shkaktim të lëndimeve të lehta trupore dhe ishte dënuar me pesë muaj heqje lirie (lirim me kusht).

<sup>64</sup> Gjykata europiane e ka marrë parasysh këtë çështje në rastin *Thorgeir Thorgeirsson kundër Islandës*, 25 qershor 1992.

<sup>65</sup> Neni 39 (4) dhe (6) LPP të RFJ- së.

<sup>66</sup> Nenet 430- 446 LPP të RFJ- së.

<sup>67</sup> Procedurat sumare dallojnë nga ato normale në disa aspekte, siç janë masat hetuese, paraburgimi, e drejta e të akzuarit për mbrojtës, roli i prokurorit në procedura, gjykimet *in absentia* si dhe shpallja e aktgjykimit.

<sup>68</sup> Neni 441 (2) LPP të RFJ- së.

<sup>69</sup> Neni 442 (1) LPP të RFJ- së. Në raste të tilla ligji thekson se pala e dëmtuar ka të drejtë për ta mbrojtur akuzën në seancën kryesore mbrenda kufizimit të propozim akuzës, shih nenin 442 (2) LPP të RFJ- së.

Në rastet e tilla, gjyqtari(t) në mënyrë të pashmëngshme prezumon në një masë, rolin e prokurorit, për të cilin mund të mendohet se mund të ndikojë në neutralitetin e gjyqtarit në objektivitet në përcaktimin e çështjes.<sup>70</sup> Dhe përsëri, kjo mund të shkelë parimet e paanësisë sipas ligjit ndërkombëtar.

## 2. Procedura për të mitur

Gjykatat komunale kryesisht merren me lëndë për të mitur. Për të siguruar që nevojat e posaçme të kryesve të mitur të veprave penale të plotësohen, ligji i zbatueshëm parasheh një procedurë të posaçme e quajtur ‘procedura për të mitur.’<sup>71</sup> Krahas kësaj, si një masë mbrojtëse shtesë, ligji parasheh që gjyqtarët e specializuar, të njohur si gjyqtarë për të mitur, merren me këto raste.<sup>72</sup>

Në bazë të procedurës për të mitur, procedurat inicohen nëpërmjet të procedurës përgatitore në vend të mbajtjes së seancave hetimore; procedurat përgatitore së këndejmi zëvendësojnë fazën e hetimeve të procedurës në rastet për të rritur. Gjatë procedurës përgatitore gjyqtari për të mitur ka pushtet të plotë që të ndërmer veprime hetimore me qëllim të vërtetimit, *inter alia*, të fakteve të cilat i përkasin veprës penale. Është vërejtur se, në bazë të sistemit të tanishëm – kur ekziston vetëm një gjyqtar për të mitur për gjykatë – gjyqtari duhet gjithashtu të veprojë si kryetar i trupit gjykues gjatë gjykimit.

Në krahasim me precedentet gjyqësore të Gjykatës Evropiane kjo praktikë mund të rrezikojë të drejtën e të miturit për t’u gjykuar nga një tribunal i paanshëm. Udhëheqja e rastit nga ana e gjykatës për të mitur gjatë procedurës përgatitore mund të përfshijë veprime të tilla, ashtu që i mituri me të drejtë të shtrojë pyetje se gjyqtari mos me të vërtetë ka krijuar mendim sa i përket fajësisë së tij/saj dhe të vë në pikëpyetje paanshmërinë e gjyqtarit.

Një shembull i një praktike të tillë ishte vëzhguar dhe vërejtur në një rast për të mitur në gjykatën komunale në Pejë/Peć. Në këtë rast dy të mitur ishin akuzuar për vjedhje. Gjykata shpalli fajtor dy të miturit për akuzat me të cilat ngarkoheshin dhe shqiptoi masë edukuese të mbikëqyrjes së shtuar nga ana e prindërve.<sup>73</sup> Gjyqtari për të mitur i cili vepronte në cilësinë e kryetarit të trupit gjykues gjatë gjykimit gjithashtu kishte udhëhequr me procedurën përgatitore.

Në tri raste (më 30 janar 2002, 23 korrik 2003 dhe 28 korrik 2003) pranë gjykatës komunale në Prizren, të miturit ishin gjykuar për vjedhje të rëndë. Në të trija rastet të miturit ishin shpallur fajtor dhe gjykata shqiptoi masë edukuese të mbikëqyrjes së shtuar nga ana e prindërve.<sup>74</sup> I njëjti gjyqtar për të mitur kishte zhvilluar procedurën përgatitore si dhe shqyrtimin kryesor.

<sup>70</sup> Sipas ligjit të zbatueshëm roli i gjyqtarit/ trupit gjykues është që të shoh se çështjet janë të ekzaminuara plotësisht dhe se është gjetur e vërteta (neni 292 LPP të RFJ- së). Në anën tjetër, roli i prokurorit në gjykim është që të prezantojë dëshmitë kundër të akuzuarit dhe ta vërtetojë ndjekjen, (nenet 45 dhe 340 LPP të RFJ- së) dhe prokurori mundet gjithashtu që të ndërrohet ose të tërhiqet nga aktakuza në çdo kohë gjatë seancës gjyqësore (nenet 51 dhe 337 LPP të RFJ- së).

<sup>71</sup> Lexo nenet 452-492 të LPP i RFJ-së pjesë për procedurën për të mitur.

<sup>72</sup> Ekzistojnë shtatë gjyqtarë për të mitur të cilët punojnë me raste për të mitur në gjykatat komunale në Kosovë. (Lexo tabelën 6 dhe 7, shtojca 4)

<sup>73</sup> Në pajtim me nenin 14 të ligjit penal të krahinës socialiste autonome të Kosovës, GZ KSAK, Nr. 20/77, (LPK)

<sup>74</sup> Në pajtim me nenin 14 LPK-së

Misioni i OSBE-në në Kosovë kishte raportuar paraprakisht mbi këtë çështje.<sup>75</sup> Përderisa pranohet fakti se sistemi i angazhimit të gjyqtarëve të specializuar në raste për të mitur është i motivuar si rezultat i nevojave të posaçme të të miturit të akuzuar, ky shqetësim nuk duhet të lejohet që të ndikojë në paanshmërinë e tribunalit. Ky problem mund të korrigjohet në mënyra të ndryshme.<sup>76</sup>

### 3. Rigjykimet

Sa i përket të drejtës për gjykim të drejtë, çdokush i cili shpallet fajtor për kryerjen e një vepre penale ka të drejtë të parashtrijë ankesë pranë gjykatës së instancës më të lartë.<sup>77</sup> Në rastet kur gjykata e shkallës së dytë kthen lëndën në rigjykim, personi i akuzuar ka të drejtë të rigjykohe nga një tribunal i paanshëm, p.sh vërtetuesit e fakteve (qoftë gjykatësit apo gjyqtarët porotë) të cilët nuk kanë përcaktuar paraprakisht mendime apo paragjykime në lidhje me lëndën në fjalë.

Siç u konsiderua më lartë, përfshirja paraprake e gjyqtarit në një rast paraqet një faktor i cili mund të vë në pikëpyetje paanshmërinë e gjykatës.<sup>78</sup> Jurisdikcionet e ndryshme nacionale jashtë Kosovës kanë zbatuar procedura të ndryshme për të siguruar që gjyqtarët apo gjyqtarët porotë, të cilët mund të konsiderohen si të anshëm për shkak të përfshirjes paraprake të tyre gjatë procedurës, të mos jenë anëtar të trupit gjykues apo porotë në rigjykim. Duket se shumë sisteme gjyqësore nacionale, të cilat janë objekt i jurisdikcionit të gjykatës evropiane (siç janë sistemet në Francë, Gjermani, Irlandë dhe Mbretërinë e Bashkuar) kanë zgjedhur një rregull e cila ndalon gjyqtarët dhe gjyqtarët porotë të cilët kanë marrë pjesë gjatë gjykimit fillestar që të marrin pjesë përsëri gjatë rigjykimit. Kjo duket të jetë mënyra më e sigurtë dhe e qëndrueshme për të mënjnuar dyshimet të cilat ngriten sa i përket paanshmërisë së trupit gjykues të rigjykimit.

Në Kosovë, megjithatë, nuk ekziston ndonjë kërkesë që rigjykimi duhet të mbahet para trupit gjykues në përbërje të ndryshme. Në vend të kësaj ligji i zbatueshëm parasheh që në rast se lënda kthehet në rigjykim, gjykata e qarkut *mund* të urdhërojë që rigjykimi të mbahet pranë një trupi gjykues krejtësisht tjetër.<sup>79</sup> Mirëpo ka shumë pak dispozita të ligjit me të cilat mund të udhëzohet gjykata se kur mund të urdhërojë që gjykimi të mbahet pranë një trupi gjykues të ri.

Misioni i OSBE-së në Kosovë e ka identifikuar si praktikë të zakonshme që trupi gjykues gjatë rigjykimit të jetë i përbërë (plotësisht apo pjesërisht) nga të njëjtët gjyqtarë sikurse edhe ata të gjykimit.

Për shembull në një lëndë pranë gjykatës komunale në Prizren, personi i akuzuar ishte shpallur fajtor për vepër penale të rëndë kundër sigurisë së trafikut publik dhe ishte dënua

<sup>75</sup> Lexo shqyrtimin e tretë të drejtësisë penale të Misionit të OSBE-së në Kosovë me titull “Shqyrtimi i sistemit të drejtësisë penale në Kosovë”, tetor 2001”, faqe 73.

<sup>76</sup> Për shembull, sistemi ku dy gjyqtar hetues do të ndërrohen ndërmjet veti ku kohëpaskohe do të merren me raste për të mitur e në pjesën e mbetur të kohës me raste penale. Një mundësi tjetër është shtimi i bashkëpunimit ndërmjet gjyqtarëve për të mitur të gjykatave të ndryshme, duke i lejuar që të ndajnë normën e punës ndërmjet veti. Lexo rekomandimet në faqe 31.

<sup>77</sup> Neni 14(5) KNDKP dhe neni 7 Protokoli Nr. 7 i KEDNJ-së.

<sup>78</sup> Përfundimisht kjo varet nga një sërë faktorësh. Gjykata evropiane ka deklaruar se mund të ekzistojnë rrethanat nën të cilat i njëjti trup gjykues mund të rigjykojë rastin, pa shkelur rregullën e paanshmërisë. Kështuqë nuk mund të thuhet se është rregull absolut që gjykata e instancës më të lartë të kthejë lëndën prapa në rigjykim pranë një trupi gjykues me përbërje tjetër. Lexo See *Ringeisen kundër Austrisë*, 6 korrik 1971, Seria A nr. 13, para. 97. Rrethanat e posaçme të secilit rast duhet të merren parasysh gjatë vlerësimit të paanshmërisë së trupit gjykues, për të zbatuar elementet subjektive dhe objektive. *Thomann kundër Zvicrës*, 10 korrik 1996, paragrafi 30–36 dhe *De Haan kundër Holandës*, 26 gusht 1998, paragrafi 49 – 51.

<sup>79</sup> Neni 385(2) KPK i RFJ-së.



me një vjet e 6 muaj burg. Pala mbrojtëse parashtroi ankesë në gjykatën e qarkut në Prizren. Gjykata e qarkut e pranoi ankesën dhe e ktheu lëndën prapa në rigjykim. Trupi gjykues gjatë rigjykimit, ishte i përbërë nga i njëjti kryetar i trupit gjykues si dhe nga njëri nga gjyqtarët porotë i cili kishte marrë pjesë gjatë gjykimit. Personi i akuzuar ishte shpallur fajtor përsëri dhe ishte dënuar me një vjet dhe gjashtë muaj burg.

Në një rast pranë të njëjtës gjykatë, më 30 gusht 2001, dy persona të akuzuar ishin shpallur fajtor për kryerje të veprës penale vjedhje e rëndë dhe u dënuan me 6 muaj burg. Gjykata e qarkut pranoi ankesën e paraqitur nga pala mbrojtëse dhe ktheu lëndën prapa në rigjykim. Në shtator 2002 lënda ishte kthyer në rigjykim dhe rigjykimi ishte udhëhequr nga i njëjti kryetar i trupit gjykues. Akuzat kundër njërit nga personat e akuzuar ishin tërhequr, përderisa personi i dytë i akuzuar ishte shpallur fajtor dhe i është caktuar dënimi me pesë muaj burg, mirëpo është liruar me kusht për një vjet.

Në një rast pranë gjykatës komunale në Mitrovicë/Mitrovica më 11 korrik 2002, personi i akuzuar ishte shpallur fajtor për vepër penale të shkakimit të lëndimeve të lehta trupore dhe posedim të paligjshëm të armëve dhe i ishte caktuar dënimi me 8 muaj burg, mirëpo ishte liruar me kusht për dy. Në dhjetor 2002, gjykata e qarkut në Mitrovicë/Mitrovica urdhëroi të mbahet rigjykimi për një akuzë të vetme. Gjatë rigjykimit trupi gjykues përfshinte të njëjtin kryetar të trupit gjykues të fazës së gjykimit. Gjykata komunale shpalli fajtor të akuzuarin dhe i caktoi dënimin prej tre muaj burg, mirëpo personi i akuzuar u lirua me kusht për një vjet.

Kryetarët e gjykatave komunale kishin deklaruar se i njëjti kryetar i trupit gjykues në shumicën e rasteve merret me lëndët që kthene prapa për rigjykim. Trupi gjykues ndërrohet vetëm në ato raste kur gjykata e qarkut e urdhëron një gjë të tillë në mënyrë shprehimore. Një nga kryetarët e gjykatave komunale kishte deklaruar se konsiderohet si ofendim nëse gjykata e qarkut urdhëron që rasti të gjykohet pranë një trupi gjykues tjetër.

Praktika e kthimit të një lënde prapa për rigjykim para të njëjtit trup gjykues (apo pjesërisht të njëjtë) mund të rezultojë në vënien në kompromis të paanshmërisë së punës së trupit gjykues të rigjykimit. Në mënyrë që të shmanget një gjë e tillë, gjykata duhet të miratojë një praktikë ku gjykatësit të cilët kanë dhënë deklaratat dëshmuuese mbi fajësinë apo pafajësinë e personit të akuzuar, të ndalohen që të jenë pjesë e trupit gjykues në fazën e rigjykimit për të njëjtin rast.

### **C. Kodi i përkohshëm i procedurës penale i Kosovës**

Kodi i përkohshëm i procedurës penale e parasheh procedurën e shkurtuar, mirëpo dispozita e cila i mundëson gjykatësit i cili ka kryer veprime hetimore të merr pjesë gjatë gjykimit të shkurtuar është hequr.<sup>80</sup> Në vend të kësaj, kodi i ri parasheh përjashtimin blanko të trupit gjykues i cili ka marrë pjesë gjatë procedurës paraprake në të njëjtin rast apo në ndonjë rast kundër të pandehurit të njëjtë.<sup>81</sup>

Një ndryshim pozitiv është se dispozita me të cilën parashihej mbajtja e gjykimit pa praninë e prokurorit nuk është inkorporuar në kodin e ri. Kodi ri parasheh në mënyrë përjashtimore që nëse

<sup>80</sup> Kryesisht, kjo i përgjigjet nenit 441(2) LPP të RFJ-së.

<sup>81</sup> Lexo nenin 40(2)(1). Ky nen është i zbatueshëm përshtatshëm në rastin e procedurës së shkurtë, si për nenin e kodit të ri të procedurës penale.

prokurori dështon që të paraqitet gjatë shqyrtimit kryesor pas ngritjes së aktakuzës nga ana e tij/saj, gjykimi duhet të shtyhet.<sup>82</sup>

Nuk ekziston ndonjë pjesë e posaçme në kuadër të kodit të ri e cila merret me procedurën për të mitur. Grupi punues i cili ishte përgjegjës për hartimin e ligjeve mbi drejtësinë për të mitur përfundoi punët rreth hartimit në fund të vitit 2002. Projekt ligjet në fjalë ende nuk janë nxjerrë dhe shpallur.

Sa i përket përbërjes së trupit gjykues në rastet e rigjykimit duhet të ceket se kodi i ri nuk përfshin dispozitat të cilat e lejojnë gjykatën e instancës së dytë që të urdhërojë që rigjykimi të mbahet para një trupi gjykues me përbërje krejtësisht tjetër.<sup>83</sup> Çështja e përbërjes së trupit gjykues gjatë rigjykimit nuk është rregulluar fare.

## PJESA 5

### E DREJTA E GJYKIMIT PUBLIK

Mbajtja e seancave gjyqësore në prani të publikut paraqet një parim themelor të të drejtës për gjykim të drejtë, duke mbajtur sistemin e drejtësisë të hapur për vëzhgim nga ana e publikut dhe së këndejmi të mbrojtë palët nga ushtrimi i pushtetit arbitrar nga ana e shtetit.

#### A. Ligji në fuqi – vendës dhe ndërkombëtar

E drejta për gjykim publik parashihet edhe me të drejtën ndërkombëtare.<sup>84</sup> Gjykata Evropiane ka deklaruar se “[...] gjykimi mbahet në pajtim me kërkesën për publicitetet vetëm nëse publiku është në gjendje të fitojë informata për datën dhe vendin [...]”.<sup>85</sup> Për këtë arsye, si pjesë e detyrimit për të siguruar publicitetin e seancës dëgjuese, organet duhet të sigurojnë që informatat mbi datën dhe vendin e seancës dëgjuese të jetë në dispozicion për publikun.<sup>86</sup> Për më tepër, në mënyrë që gjykimi të jetë publik konsiderohet se duhet të jetë e hapur për publikun në përgjithësi që të marrin pjesë gjatë gjykimit dhe qasja nuk mund të kufizohet për kategoritë e caktuara të personave.<sup>87</sup>

Ligji i zbatueshëm në Kosovë është në pajtim me këtë kërkesë. Ajo parasheh që shqyrtimi kryesor të jetë publik<sup>88</sup> dhe përjashtimi i publikut lejohet vetëm nën rrethana të kufizuara.<sup>89</sup>

<sup>82</sup> Lexo dispozitat që qeverisin procedurën e zakonshme në nenin 340 të kodit të ri. Ky nen konsiderohet të jetë i zbatueshëm, përshtatshëm në rastin e procedurës së shkurtë, lexo nenin 461 të kodit të ri.

<sup>83</sup> Shih nenin 424 i Kodit të Përkohshëm të Procedurës Penale në krahasim me nenin 386 të LPP të RFJ-së.

<sup>84</sup> E drejta ndërkombëtare parashikon që “çdo person ka të drejtë për gjykim publik”, shih nenin 6(1) KEDNj; neni 14(1) MNDCP; neni 10 i Deklaratës Univerzale për të Drejtat e Njeriut. Vëreni se kjo e drejtë është objekt i kufizimeve në interes të moralit, rendit publik apo sigurisë kombëtare në një shoqëri demokratike, ku interesat e të miturve apo jeta private e palëve kërkon një gjë të tillë apo deri në masën e duhur e cila është e domosdoshme në bazë të mendimit të gjykatës dhe atë në rrethana nën të cilat publiciteti do të paragjykonte interesat e drejtësisë.

<sup>85</sup> *Riepan kundë. Austrisë*, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut, 14 nëntor 2000, paragrafi 29. Shih gjithashtu *Van Meurs kundër Holandës*, Komiteti për të drejtat e njeriut, numri komunikues 215/1986, 13 korrik 1990.

<sup>86</sup> *Van Meurs kundër holandës*, Komiteti për të drejtat e njeriut, numri komunikues 215/1986, 13 korrik 1990 paragrafi 6.2.

<sup>87</sup> Shih Komentin i përgjithshëm i Komitetit për të drejtat e njeriut, 13; barazia para gjyqit dhe e drejta për gjykim të drejtë dhe publik nga një gjykatë e pavarur e përcaktuar me ligj, paragrafi 6.

<sup>88</sup> Neni 287(1) LPP i RFJ-së.

## B. Gjetjet

Misioni i OSBE-së në Kosovë ka identifikuar një numër të gjykatave komunale në Kosovë të cilat nuk kanë vënë në dispozicion në mënyrë konsistente informatat në lidhje me vendin dhe kohën e mbajtjes së seancave dëgjuese. Oraret për mbajtjen e gjykimit nuk shfaqen në mënyrë të rregullt (qoftë jashtë gjykatores, sallave të gjykimit apo zyreve të kryetarëve të trupave gjykues të rasteve përkatëse), dhe gjithashtu këto informata nuk vihen në dispozicion as nga administratori i gjyqit.<sup>90</sup>

Mungesa e konsistencës gjatë procedurës – si ndërmjet gjykatave dhe gjithashtu gjatë punës së përditshme në vetë gjykata – në ofrimin e informatave të tilla është përbërësi kryesor i problemit.<sup>91</sup> Në shumicën e rasteve, mënyra e vetme për të fituar informatat e nevojshme është që të flitet personalisht me kryetarin e trupit gjykues të rastit.

Përpos vështirësive në marrjen e informatave përkitazi me vendin dhe datën e mbajtjes së seancave dëgjuese, ka pasur raste kur qasja e publikut në gjykim ka qenë e kufizuar. Në disa raste vetëm personat e thirrur për të marrë pjesë në gjykim apo personat e ndërlidhur me palët në procedurë janë lejuar të hyjnë në gjykatore, dhe me këtë është penguar qasja e publikut në gjykata.<sup>92</sup> Mëtutje, shumica e gjykimeve në gjykatat komunale janë mbajtur në zyret e kryetarit të trupit gjykues. Këto zyre nuk janë të dizajnuara që t'i mundësojnë publikut të marrë pjesë gjatë gjykimit, duke marrë parasysh se prania e personelit gjyqësor, palëve dhe përfaqësuesve të tyre ligjor zëjnë pjesën më të madhe të hapësirës.

Praktikat e paraqitura si më lartë shpeshherë e bëjnë të vështirë për publikun të marrë informata dhe të marrë pjesë gjatë seancave publike në gjykatat komunale. Edhe pse informimi dhe qasja në gjykim mundet eventualisht t'i mundësohet një numri të caktuar pjesëtarëve të publikut që kanë njohuri për sistemin, kërkohet të bëhen përpjekje të mëdha për të hequr këtë pengesë për vëzhgimin e gjykimit nga ana e publikut. Kjo në të kundërtën mund të ndikojë në mënyrë negative në të drejtën e të akuzuarit për gjykim publik.

Duhet të ceket se, pas rekomandimeve paraprake të dhëna nga OSBE-ja, DD-ja lëshoi një qarkore të drejtësisë më 4 shkurt 2004, mbi qasjen e publikut në drejtësi.<sup>93</sup> Së këndejmi DD-ja inkurajoi Departamentin e Administratës Gjyqësore që të sigurojë që qarkorja e drejtësisë të jetë e zbatuar në mënyrë të duhur. Misioni i OSBE-së në Kosovë mirëpret një nismë të tillë.

---

<sup>89</sup> Shih nenin 288 i LPP të RFJ-së e cila lejon përjashtimin e publikut nëse një gjë e tillë kërkohet për të ruajtur fshehtësinë, rendin dhe ligjin, për të mbrojtur interesat e të miturit apo për të mbrojtur interesat tjerë të veçanta të komunitetit. Mëtutje, neni 324(3) i LPP të RFJ-së lejon që trupi gjykues të përjashtojë publikun nëse personi nën moshën 14 vjeçare dëgjohej në cilësinë e dëshmitarit. Vëreni gjithashtu nenin 461 dhe 482 të LPP të RFJ-së përkitazi me përjashtimin e publikut gjatë marrjes në pyetje të të miturve.

<sup>90</sup> Në përgjithësi oraret për mbajtjen e gjykimeve nuk shpallen fare në gjykatat komunale. Përjashtime janë gjykatat komunale në Mitrovicë/Mitrovica, Skenderaj/Srbica dhe Vushtrri/Vučitrn ku oraret e gjykimeve shfaqen jashtë zyrës së kryetarit përkatës të trupit gjykues përderisa në gjykatën komunale në Malishevë/Mališevo orari mujor i lëndëve shpallen në tabelën e shpalljeve. Duhet të ceket gjithashtu se orari i gjykimeve në gjykatën komunale në Vushtrri/Vučitrn nuk shfaq listën e emrave të personave të akuzuar.

<sup>91</sup> Për shembull, në një rast administratori i gjykatës do të ketë informata në dispozicion, përderisa në tjetrin jo; në një orari i gjykimeve shpallet në rastin tjetër jo.

<sup>92</sup> Një gjë e tillë ka ndodhur në gjykatën komunale në Mitrovicë/Mitrovica, ku qasja e publikut është e kufizuar për shkak të kufizimeve në transportin deri në gjykatë, e cila gjendet në veri të Mitrovicës, nga jugu i Mitrovicës.

<sup>93</sup> Qarkorja e drejtësisë 2003/7.

### **C. Kodi i përkohshëm i procedurës penale i Kosovës**

Kodi i përkohshëm i procedurës penale i Kosovës ruan të drejtën për gjykim publik me përjashtim të publikut vetëm nën rrethana të kufizuara.<sup>94</sup> Këto dispozita mund të krahasohen me ato të KPP të RFJ-së, me një dispozitë të shtuar ku gjyqtari mund të përjashtojë publikun me qëllim të mbrojtjes së palës së dëmtuar apo dëshmitarit.

---

<sup>94</sup> Neni 328(1) dhe 329 i kodit të përkohshëm të procedurës penale.

## PJESA 6

### E DREJTA E MARRJES NË PYETJE TË DËSHMITARIT

Vështirësitë në sigurimin e pjesëmarrjes së palëve dhe dëshmitarëve gjatë procedurës mund të ndikojë në të drejtën e të akuzuarit për të marrë në pyetje dëshmitarët dhe në vonesa të panevojshme.

#### A. Ligji në fuqi – vendës dhe ndërkombëtar

E drejta e të akuzuarit për të marrë në pyetje dëshmitarët të cilët dëshmojnë kundër tyre paraqet një aspekt themelor të të drejtës për gjykim të drejtë dhe gjykata është e obliguar të ndërmarrë hapa pozitiv për të siguruar që kjo e drejtë respektohet gjatë zhvillimit të procedurës.<sup>95</sup> Në këtë drejtim, konsiderohet se deklaratat e dëshmitarëve të dhëna gjatë procedurës paraprake për prokurorinë, të marra në mungesë të avokatit mbrojtës nuk mund të jenë bazë e aktgjykimit.<sup>96</sup>

Në Kosovë, është e praktikë e zakonshme që dëshmitarët të dëshmojnë gjatë gjykimit personalisht, edhe pse ata mund t'i kenë dhënë dëshmi gjyqtarit hetues gjatë procedurës paraprake. Ligji vendës lejon disa devijime nga kjo procedurë nën rrethana të kufizuara.<sup>97</sup> Kjo praktikë lejon që i akuzuari apo avokati i tij/saj mbrojtës të marrë në pyetje dëshmitarët gjatë gjykimit.<sup>98</sup> Krahas kësaj, ligji i zbatueshëm parashih mundësinë për prokurorin, të dyshuarin dhe avokatin mbrojtës që të marrin pjesë gjatë marrjes në pyetje të dëshmitarëve gjatë procedurës hetimore dhe të marrë në pyetje dëshmitarët nën rrethana të kufizuara.<sup>99</sup>

#### B. Gjetjet

Në një sërë rastesh janë paraqitur vështirësi në sigurimin e pranisë së dëshmitarëve gjatë gjykimit, dhe në vend të kësaj gjykata ka lexuar për procesverbal deklaratat e dëshmitarëve të dhëna gjatë

<sup>95</sup> Neni 14(3)(e) e MNDPC-së dhe neni 6(3)(d) i KEDNj-së. Shih gjithashtu *Barbera, Messegue dhe Jabardo kundër Spanjës*, Gjykata evropiane për të drejtat e njeriut, 6 dhjetor 1988, paragrafi 78.

<sup>96</sup> Shfrytëzimi i deklaratave të dëshmitarëve të dhëna gjatë procedurës paraprake si provë, nëse dëshmitari gjatë shqyrtimit kryesor nuk dëshmon para trupit gjykues, nuk është në pajtim me nenin 6(3)(d) e KEDNj-së. Sidoqoftë, dëshmitë e tilla mund të rezultojnë në shpalljen e fajësisë nëse ekzistojnë dëshmi tjera të cilat e mbështesin deklaratën e dhënë, *shih Delta kundër Francës*, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut, 26 prill paragrafi 28 - 31. Megjithatë, vëreni se nuk është me rëndësi kyçe që i akuzuari, apo avokati i tij/saj mbrojtës të marrin në pyetje personin gjatë fazës së gjykimit nëse atyre u shtë mundësia t'a bëjnë këtë gjatë fazës paraprake, shih *Solakov kundër Ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë*, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut, 31 tetor 2001 (31 janar 2002), para. 59–66. Vëreni gjithashtu komentimin e përgjithshëm Nr. 13 paragrafi 12 i Komitetit të të drejtave të njeriut.

<sup>97</sup> Neni 333(2) KPP i RFJ-së lejon që deklaratat e dëshmitarëve që jipen para gjyqtarit hetues të lexohen për procesverbal nën rrethana të caktuara, siç është rasti kur palët japin pëlqimin e tyre apo nën rrethana përjashtimore (siç është rasti nëse dëshmitari ka vdekur, është bërë mentalisht i sëmurë apo nuk mund të gjendet.) Sidoqoftë, neni 333(2) duhet të interpretohet dhe zbatohet në dritën e standardeve për gjykim të drejtë. Së këndejmi, deklaratat me shkrim që jipen për ndjekjen penale në mungesë të personit të akuzuar apo avokatit të tij/saj mbrojtës nuk mund të formojnë bazë për aktgjykim.

<sup>98</sup> Sa i përket të drejtës së personit të akuzuar për t'i parashtruar pyetje dëshmitarit shih nenin 327 të LPP të RFJ-së. Shih gjithashtu Gjykatën Supreme të Kosovës në rastin *Saramati kundër prokurorit publik*, 9 tetor, 2002 (në paragrafin 39) ku gjykata ka aplikuar këto parime dhe ka pruar vendim se këto të drejta kërkojnë që personit të akuzuar t'i jipet mundësi adekuate për të kundërshtuar dhe marrë në pyetje dëshmitarin i cili dëshmon kundër tij/saj.”

<sup>99</sup> Shih nenet 168(4) dhe (8) LPP të RFJ-së. Kjo dispozitë është e dizajnuar që të ofrojë rrethanë lehtësuese për paragjykimin i cili mund t'i bëhet të akuzuarit pasi që deklarata e dëshmitarit të jetë lexuar për procesverbal gjatë gjykimit.

procedurës hetimore, përkundër faktit se deklarata është dhënë në mungesë të avokatit mbrojtës apo të akuzuarit.

Për shembull në një rast pranë gjykatës komunale në Prishtinë/Priština më 24 korrik 2003, dy të akuzuar ishin akuzuar me vjedhje të rëndë dhe u dënuan me 1 vjet e tre muaj burgim. Dy dëshmitarë të prokurorisë nuk dëshmuuan në gjyq atë ditë dhe në vend të kësaj gjykata vendosi të lexojë deklaratat që i kishin dhënë gjyqtarit hetues, këto deklarata janë marrë në mungesë të të akuzuarit dhe avokatit mbrojtës. Avokati i caktuar nga gjykata nuk kundërshtoi leximin e deklaratave të dëshmitarëve.<sup>100</sup>

Në një rast pranë gjykatës komunale në Prizren më 25 qershor 2003, dëshmitari kryesor dhe pala e dëmtuar nuk u paraqitën gjatë gjykimit edhe përkundër se ishin thirrur në mënyrë të duhur. Me qëllim që të mos shtyhet gjykimi, deklaratat e tyre me shkrim që ishin marrë në mungesë të avokatit mbrojtës dhe të akuzuarit dhe ishin lexuar për procesverbal. Kjo ishte bërë përkundër faktit se gjykata kishte bërë vetëm një përpjekje për të thirrur dëshmitarët. Aktgjykimi ishte sjellur në të njëjtën ditë. I akuzuari u shpall fajtor për vepër penale të shkakimit të lëndimeve të lehta trupore dhe i'u caktua dënimi me 4 muaj burg, mirëpo u lirua me kusht për një vjet. Në këtë rast, i akuzuari mbronte vetën dhe nuk kishte avokat mbrojtës që t'a përfaqësojë.

Misioni i OSBE-së në Kosovë është i mendimit se mënyra nëpërmjet të së cilës dëshmitë ishin dëgjuar në këto raste, ku nuk i ishte lejuar të akuzuarit që të marrë në pyetje dëshmitarët deklaratat e të cilëve përbëjnë bazën kryesore të aktgjykimit, paraqet një shkelje të ligjit të zbatueshëm dhe mund të ketë paragjykuar të drejtën e të akuzuarit për gjykim të drejtë. Misioni i OSBE-së në Kosovë përsërit faktin se deklaratat e dëshmitarëve të marra pa praninë e avokatit mbrojtës apo të pandehurit nuk mund të pranohen dhe nuk mund të shërbejnë si bazë e aktgjykimit.<sup>101</sup>

### **C. Kodi i përkohshëm i procedurës penale i Kosovës**

Kodi i përkohshëm i procedurës penale i Kosovës nuk përfshin një referim të drejtpërdrejtë ndaj të drejtës së të akuzuarit për të marrë në pyetje dëshmitarin i cili dëshmon kundër tij. Megjithatë, në kod është e cekur se pasi që prokuroria dhe trupi gjykues të kenë marrë në pyetje dëshmitarët, kryetari i trupit gjykues duhet të pyes nëse i akuzuari ka diçka të prezentojë.<sup>102</sup> Sidoqoftë, nuk ka dyshim se një e drejtë e tillë parashihet edhe me kodin e ri. Në të vërtetë, kodi i ri parasheh që deklaratat e dëshmitarëve të cilat i jipen policisë apo prokurorit janë të pranueshme gjatë gjykimit vetëm nëse pala mbrojtëse ka pasur mundësi 'i marrë në pyetje dëshmitarët gjatë ndonjë faze të caktuar të procedurës penale.

<sup>100</sup> Është e rëndësishme të ceket se përkundër mungesës së kundërshtimit nga ana e avokatit mbrojtës në emër të të akuzuarit, e drejta e të akuzuarit për të marrë në pyetje dëshmitarët kundër tij/saj qëndron ende dhe se çdo heqje dorë nga kjo e drejtë duhet të jetë paekuivoke. Shih Sadak dhe të tjerët kundër Turqisë, Gjykata evropiane për të drejtat e njeriut, 17 gusht 2001, 29900/96; 29901/96; 29902/96 dhe 29903/96, para 67; Colozza kundër Italisë, Gjykata evropiane për të drejtat e njeriut, 12 shkurt 1985, 9024/80, para 28.

<sup>101</sup> Lexo shqyrtimin e parë mbi sistemin e drejtësisë penale të OSBE-së, 1 shkurt 2000 – 31 korrik 2000, faqe 21.

<sup>102</sup> Neni 370 i kodit të përkohshëm të procedurës penale.

## **PJESA 7**

### **KONKLUZION**

Gjykatat komunale luajnë një rol jetësor në sistemin gjyqësor të Kosovës. Megjithatë, gjykatat për momentin janë duke u përballur me një sërë vështirësish të cilat ndikojnë në administrimin e drejtësisë në përgjithësi dhe në të drejtën për gjykim të drejtë në veçanti.

Shumica e problemeve – siç janë rritja e numrit të rasteve të pazgjidhura dhe vonesat në zgjidhjen e tyre – kërkojnë një reformë strukturore; përderisa të tjerët kërkojnë zgjidhje legjislative dhe administrative. Kodi i përkohshëm i procedurës penale arrin të drejtësojë këto probleme vetëm deri në një masë të caktuar. OSBE-ja është e mendimit se shumica e vështirësive mund të adresohen pa reforma të shtrenjta dhe gjithëpërfshirëse. Sidoqoftë, kjo gjendje duhet të adresohet urgjentisht. Nëse problemet ekzistuese lihen të pakontrolluara, gjendja në këtë drejtim mund të keqësohet edhe më tutje; rritja e numrit të rasteve të pazgjidhura mund të infektojë tërë sistemin përderisa standardet e gjykimit të drejtë mund të rrezikohen gjithnjë e më tepër gjatë përpjekjes për uljen e stërngarkesës me lëndë.

Autoritetet duhet gjithashtu të ndërmarrin hapa të menjëhershëm në implementimin e këtyre ndryshimeve të cilat janë të domosdoshme për të siguruar funksionimin e duhur të administrimit të drejtësisë në gjykatat komunale.

## REKOMANDIMET

### E drejta e gjykimit brenda kohës së arsyeshme

- Këshilli Gjyqësor dhe Prokurorial i Kosovës duhet të rishqyrtojë numrin e gjyqtarëve që janë caktuar të punojnë në gjykatat komunale me një pikëpamje të korrigjimit të mungesës së baraspeshës që ekziston në normën e punës. Për më tepër, duhet të vihet si prioritet emërimi i gjyqtarëve të rinjë komunalë të cilët duhet të plotësojnë vendet e zbrazëta.
- DD-ja duhet të zhvillojë një hulumtim për të përcaktuar arsyet për një menaxhim më të mirë të lëndëve në gjykatat komunale. Pasi të përcaktohet, këto praktikë e mira administrative të gjykatave duhet të ndahen me kryetarët e të gjitha gjykatave. DD-ja duhet të ndihmojë në zbatimin e këtyre praktikave të mira me qëllim të dhënies së ndihmës gjykatave për shfrytëzim më të mirë të resurseve dhe për të eliminuar vonesat e panevojshme në procesimin e lëndëve.
- DD-ja duhet të themelojë një mekanizëm i cili siguron një lidhje të drejtpërdrejtë ndërmjet gjykatave komunale dhe prokurorive përkatëse. Në të gjitha rajonet, prokurorët duhet të caktohen në një apo më shumë gjykata komunale, në vend se ata të udhëtojnë nëpër regjione.
- DD-ja duhet të lëshojë një qarkore me të cilën informohen gjyqtarët, policia hetuese dhe anëtarët e njësisë regjionale të arrestimeve dhe ekzekutimit të fletëarresteve gjyqësore mbi procedurën e paraparë me urdhëresën administrative 2002/16.<sup>103</sup> Krahas kësaj duhet të dizajnohet një sistem më fleksibil për kërkesat për informim që bëhen nga gjykatat dhe i adresohen regjistrisë civil, duke përfshirë këtu edhe një formular të standardizuar i cili duhet të plotësohet nga kryetari i trupit gjykues dhe i përcillet regjistrisë civil nëpërmjet të DD-së.

### E drejta e gjykimit nga tribunali i themeluar me ligj

- Kryetarët e gjykatave komunale dhe gjykatësit e këtyre gjykatave duhet të sigurojnë që për secilin rast të caktohen një numër i duhur i gjyqtarëve porotë. Nëse një gjyqtarë nuk merr pjesë gjatë shqyrtimit kryesor atëherë seanca kryesore duhet të shtyhet deri në caktimin e gjyqtarit të ri porotë dhe deri sa ai të ketë mundësi të marrë pjesë gjatë seancës kryesore.

### E drejta për tribunal të paanshëm

- Instituti Gjyqësor i Kosovës duhet, si pjesë e trajnimit për gjyqtarë mbi kodin e përkohshëm të procedurës penale, të vë në pah ndryshimet që janë bërë në procedurën e shkurtuar (sumare). Kjo do të ndihmojë që të sigurohet pajtueshmëria e këtyre dispozitave me standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut.
- Kryetarët e gjykatave komunale duhet të sigurojnë që lëndët për të mitur të zgjidhen në atë mënyrë ashtu që një gjyqtarë të merret me procedurën përgatitore ndërsa tjetri me shqyrtimin kryesor.

---

<sup>103</sup> Urdhëresa administrative Nr. 2002/16, mbi zbatimin e rregullores Nr. 2000/13 e ndryshuar me urdhëresën administrative Nr. 2003/19.



- Kryetarët e gjykatave komunale duhet të miratojnë një politikë në bazë të së cilës një trup tjetër gjykues do të caktohet për rigjykim për të njëjtin rast pas paraqitjes së ankesës. Kjo do të lehtësojë dyshimet lidhur me paanshmërinë e tribunalit gjatë rigjykimit.

#### **E drejta e gjykimit publik**

- Departamenti i Administratës Gjyqësore duhet të sigurojë që qarkorja e drejtësisë 2003/7 të zbatohet sa më shpejtë që është e mundur.

#### **E drejta e marrjes në pyetje të dëshmitarit**

- Gjykatat instancore dhe Gjykata Supreme duhet të sigurojnë që deklaratat e dëshmitarëve të marra në mungesë të avokatit mbrojtës apo të pandehurit nuk do të pranohen dhe nuk mund të shërbejnë si bazë e aktgjykimit.
- Instituti Gjyqësor i Kosovës duhet, si pjesë e trajnimit për gjyqtarë mbi kodin e përkohshëm të procedurës penale, të vë në pah dispozitën e re të paraparë me nenin 156(2) të këtij kodi, i cili parasheh që deklaratat e dëshmitarëve të dhëna para policisë apo prokurorit janë të pranueshme në gjykatë vetëm kur personit të akuzuar apo avokatit të tij/saj mbrojtës t'i jipet mundësi t'i kundërshtojë ato duke marrur në pyetje dëshmitarët gjatë fazave të caktuara të procedurës penale.

## SHTOJCA 1 GJYQTARËT E GJYKATAVE KOMUNALE

**Tabela 1. Numri i gjyqtarëve në vitin 1989 dhe 2003**

Gjykata Komunale	Numri i posteve vitin 1989	Numri i posteve në vitin 2003	Gjyqtarë në vitin 2003 (DAGj) <sup>104</sup>
Gjykata Komunale në Gjiilan/Gnjilane	11	8	6
Gjykata Komunale në Kamenicë/Kamenica	5	6	3
Gjykata Komunale në Viti/Vitina	6	4	3
Gjykata Komunale në Prizren	16	10	9
Gjykata Komunale në Dragash/Dragaš	4	6	5
Gjykata Komunale në Malishevë/Mališevo	5	4	3
Gjykata Komunale në Rahovec/Orahovac	7	6	6
Gjykata Komunale në Suharekë/Suva Reka	8	5	4
Gjykata Komunale në Pejë/Peć	15	10	10
Gjykata Komunale në Deçan/Dečani	6	4	4
Gjykata Komunale në Gjakovë/Dakovica	10	8	6
Gjykata Komunale në Istog/Istok	6	4	3
Gjykata Komunale në Klinë/Klina	6	4	3
Gjykata Komunale në Prishtinë/Priština	32	28	22
Gjykata Komunale në Ferizaj/Uroševac	11	8	7
Gjykata Komunale në Glogovac/Glogovac	5	5	3
Gjykata Komunale në Kaçanik/Kaçanik	4	1	1
Gjykata Komunale në Lipjan/Lipljan	7	6	5
Gjykata Komunale në Podujevë/Podujevo	6	6	5
Gjykata Komunale në Mitrovicë/Mitrovica	17	9	9
Gjykata Komunale në Skenderaj/Srbica	4	4	4
Gjykata Komunale në Vushtrri/Vučitrn	8	8	5
Gjykata Komunale në Leposavić/Leposaviq	6	5	1
Gjykata Komunale në Zubin Potok	4	4	1
Departamenti në Shtërpçë/Štrpce	-	2	0
<b>Gjithsejt:</b>	<b>209</b>	<b>165</b>	<b>128</b>

<sup>104</sup> Siq përmendet më lartë, duhet të theksohet se sipas Këshillit Gjyqësor dhe Prokurorial të Kosovës, për shkak të mënyrës tjetër të vlerësimit të numrave, 137 gjyqtarët e gjykatave komunale kishin qenë të punësuar në vitin 2003 dhe se 28 vende kan mbetur të hapura.

## SHTOJCA 2 LËNDËT PËR NJË GJYKATË

**Tabela 2. Numri i lëndëve në Gjykatë 2002<sup>105</sup>**

Gjykata Komunale në	Lëndët në fillim të vitit 2002	Lëndët e pranuarra 2002	Gjithsejt lëndë në procedurë 2002	Lëndët e zgjidhura 2002	Kapaciteti v. ngarkesa me lëndë
Gjilan/Gnjilane	2,336	6,624	8,960	5,387	81%
Kamenicë/Kamenica	314	2,821	3,135	2,817	100%
Viti/Vitina	531	2,917	3,448	2,635	90%
Prizren	6,108	12,759	18,867	11,251	88%
Dragash/Dragaş	77	2,394	2,471	2,347	98%
Malishevë/ Mališevo	391	4,486	4,877	4,384	98%
Rahovec/Orahovac	1,202	6,698	7,900	6,671	100%
Suharekë/Suva Reka	1,187	4,992	6,179	4,912	98%
Pejë/Peç	8,304	25,962	34,266	17,172	66%
Deçan/Deçani	404	3,033	3,437	2,838	94%
Gjakovë/Đakovica	1,662	15,012	16,674	9,991	67%
Istog/Istok	617	3,672	4,289	3,455	94%
Klinë/Klina	679	4,268	4,947	3,883	91%
Prishtinë/Priština	5,143	22,878	28,021	15,604	68%
Ferizaj/Uroševac	1,778	8,028	9,806	7,064	88%
Glllogovc/Glogovac	216	2,893	3,109	2,689	93%
Kaçanik/Kaçanik	723	3,913	4,636	3,426	88%
Lipjan/Lipljan	139	5,876	6,015	5,802	99%
Podujevë/Podujevo	332	4,281	4,613	3,845	90%
Mitrovicë/Mitrovica	1,049	4,897	5,946	4,086	83%
Skenderaj/Srbica	43	2,479	2,522	2,399	97%
Vushtrri/Vučitrn	303	5,662	5,965	5,255	93%
Leposavić/Leposaviq	0	0	0	0	
Zubin Potok	0	0	0	0	
<b>Gjithsejt:</b>	<b>33,538</b>	<b>156,545</b>	<b>190,083</b>	<b>127,913</b>	<b>82%<sup>106</sup></b>

<sup>105</sup> Këta numra janë bazuar në të dhënat statistikore të ofruara nga Departamenti i administratës gjyqësore.

<sup>106</sup> Kjo tregon përqindje e numrit total të lëndëve të zgjidhura në krahasim me numrin total të lëndëve të pranuarra gjatë vitit 2002.

**Tabela 3. Numri i lëndëve në gjykata 2003<sup>107</sup>**

<b>Gjykata Komunale në:</b>	<b>Lëndët në fillim të vitit 2003</b>	<b>Lëndët e pranuarra 2003</b>	<b>Gjithsejt lëndë në procedurë</b>	<b>Lëndët e zgjidhura</b>	<b>Kapaciteti v. Ngarkesa me lëndë</b>
Gjilan/Gnjilane	3,569	7,341	10,910	6,485	88%
Kamenicë/Kamenica	305	3,326	3,631	3,262	98%
Viti/Vitina	800	4,715	5,515	4,245	90%
Prizren	7,599	12,258	19,857	10,532	86%
Dragash/Dragaš	121	3,628	3,749	3,646	100%
Malishevë/ Mališevo	487	6,491	6,978	6,341	98%
Rahovec/Orahovac	1,229	7,122	8,351	6,829	96%
Suharekë/Suva Reka	1,009	6,141	7,150	6,115	100%
Pejë/Peć	17,062	18,802	35,864	16,582	88%
Deçan/Dečani	598	3,959	4,557	3,871	98%
Gjakovë/Đakovica	6,683	13,958	20,641	11,844	85%
Istog/Istok	834	5,121	5,955	4,567	89%
Klinë/Klina	1,063	6,505	7,568	6,184	95%
Prishtinë/Priština	12,404	32,055	44,459	25,690	80%
Ferizaj/Uroševac	2,742	11,269	14,011	9,660	86%
Gllgovac/Glogovac	419	5,454	5,873	5,438	100%
Kaçanik/Kaçanik	1,170	4,318	5,488	3,189	74%
Lipjan/Lipljan	205	7,144	7,349	7,052	99%
Podujevë/Podujevo	768	5,745	6,513	5,218	91%
Mitrovicë/Mitrovica	1,860	9,285	11,145	8,156	88%
Skenderaj/Srbica	118	4,923	5,041	4,742	96%
Vushtrri/Vučitrn	668	7,609	8,277	7,590	100%
Leposavić/Leposaviq	0	590	590	395	67%
Zubin Potok	0	223	223	162	73%
<b>Gjithsejt:</b>	<b>61,713</b>	<b>187,982</b>	<b>249,695</b>	<b>167,795</b>	<b>89%<sup>108</sup></b>

<sup>107</sup> Vërejtje: lëndët në procedurë në fillim të vitit 2003 nuk i përbëjnë ato raste nga viti 2002 që janë bartur në instanca tjera.

<sup>108</sup> Kjo tregon përqindjen e numrit të lëndëve të zgjidhura në krahasim me numrin e lëndëve të pranuarra gjatë vitit 2003.

### SHTOJCA 3 LLOJET E LËNDËVE

**Tabela 4. Numri i lëndëve sipas kategorisë v. 2002**

Lloji i lëndës	Lëndë të pranuar	Lëndë në procedurë	Lëndë të zgjidhura	Lëndë të pazgjidhura 2001	Lëndë të transferuara <sup>109</sup>
Hetime	3,689	5,343	3,025	2,224	94
Ankesa gjatë hetit.	631	634	610	2	22
Lëndë penale	9,434	16,234	5,371	10,647	216
Lëndë civile	10,188	18,968	5,868	12,999	101
Me të mitur	995	1,588	669	919	0
Regjistrimin e tokës	1,259	1,259	1,259	0	0
Përmbarime	21,870	35,005	3,750	31,255	0
Trashëgimi	3,505	4,570	2,894	1,676	0
Procedurë jashtkontestimore	4,621	5,728	4,216	1,512	0
Tjera	99,909	100,168	99,749	418	1
Urdhërpagesë	444	586	502	84	0
<b>Gjithsejt:</b>	<b>156,545</b>	<b>190,083</b>	<b>127,913</b>	<b>61,736</b>	<b>434</b>

**Tabela 5. Numri i lëndëve sipas kategorisë 2003**

Lloji i lëndës	Lëndë të pranuar	Lëndë në procedurë	Lëndë të zgjidhura	Lëndë të pazgjidhura 2002	Lëndë të transferuara
Hetime	4,178	6,402	3,958	2,224	3
Ankesa gjatë hetit.	686	688	660	2	30
Lëndë penale shk.II-të	10,595	21,242	5,458	10,647	62
Me të mitur	1,178	2,097	880	919	3
Civil cases	10,767	23,766	6,288	12,999	401
Trashëgimi	3,436	5,112	3,150	1,676	3
Procedurë jashtkontestimore	3,818	5,330	3,120	1,512	4
Regjistrimin e tokës (intabulacionet) <sup>110</sup>	3,907	3,907	3,843	0	1
Përmbarim (civile)	16,068	46,964	7,660	30,896	13
Përmbarim (penale)	1,862	2,198	1,080	336	11
Tjera	131,487	131,989	131,698	502	12
<b>Gjithsejt:</b>	<b>187,982</b>	<b>249,695</b>	<b>167,795</b>	<b>61,713</b>	<b>543</b>

<sup>109</sup> Lëndë të bartura në gjykata tjera.

<sup>110</sup> Siq janë ngarkesat.

## SHTOJCA 4 LËNDËT ME TË MITURIT

**Tabela 6. Lëndët me të miturit 2002**

Gjykata Komunale në:	Lëndë të pranuar	Lëndë në procedurë	Lëndë të zgjidhura	Lëndë të pazgjidhura	Lëndë të transferuara <sup>111</sup>
Gjilan/Gnjilane	174	291	168	123	0
Prizren	231	440	172	268	0
Pejë/Peć	105	117	94	23	0
Prishtinë/Priština	202	368	101	62	0
Ferizaj/Uroševac	91	145	48	267	0
Mitrovicë/Mitrovica	125	126	47	97	0
Gjakovë/Đakovica	67	101	39	79	0
<b>Gjithsejt:</b>	<b>995</b>	<b>1588</b>	<b>669</b>	<b>919</b>	<b>0</b>

**Tabela 7. Lëndët me të miturit 2003**

Gjykata Komunale në:	Lëndë të pranuar	Lëndë në procedurë	Lëndë të zgjidhura	Lëndë të pazgjidhura	Lëndë të transferuara <sup>112</sup>
Gjilan/Gnjilane	180	303	193	110	0
Prizren	299	567	209	358	0
Pejë/Peć	86	109	86	23	0
Gjakovë/Đakovica	112	174	56	118	0
Prishtinë/Priština	226	493	146	344	3
Ferizaj/Uroševac	146	243	96	147	0
Mitrovicë/Mitrovica	129	208	94	114	0
<b>Gjithsejt:</b>	<b>1178</b>	<b>2097</b>	<b>880</b>	<b>1214</b>	<b>3</b>

<sup>111</sup> Lëndë të transferuara në gjykatat tjera.

<sup>112</sup> Lëndë të transferuara në gjykatat tjera.

## SHTOJCA 5 NORMA PËR NJË GJYQ TAR

**Tabela 8. Mesatarja e numrit të lëndëve komplekse për një gjyqtar në v. 2002**

<b>Gjykata Komunale në:</b>	<b>Numri i gjyqtarëve<sup>113</sup></b>	<b>Lëndë të pranuar</b>	<b>Norma për një gjyqtar</b>	<b>Lëndë të zgjidhura për një gjyqtar</b>
Gjilan/Gnjilane	6	2,102	350.3	261.7
Kamenicë/Kamenica	4	473	118.3	133.3
Viti/Vitina	4	679	169.8	130.8
Prizren	10	3,378	337.8	225.3
Dragash/Dragaş	5	348	69.6	68.4
Malishevë/ Mališevo	3	574	191.3	186.7
Rahovec/Orahovac	6	1,376	229.3	215.0
Suharekë/Suva Reka	4	731	182.8	163.0
Pejë/Pec	9	1,940	215.6	171.4
Deçan/Decani	4	608	152.0	126.3
Gjakovë/Đakovica	7	4,169	595.6	319.0
Istog/Istok	3	449	149.7	126.0
Klinë/Klina	2	765	382.5	250.0
Prishtinë/Priština	22	5,521	251.0	120.3
Ferizaj/Uroševac	8	1,993	249.1	207.3
Glogovc/Glogovac	2	477	238.5	180.0
Kaçanik/Kacanik	1	893	893.0	580.0
Lipjan/Lipljan	5	637	127.4	126.0
Podujevë/Podujevo	6	869	144.8	124.3
Mitrovicë/Mitrovica	4	1,404	351.0	215.8
Skenderaj/Srbica	4	498	124.5	120.8
Vushtrri/Vucitrn	5	1,319	263.8	238.8
Leposavic/Leposaviq	0	0	0.0	0.0
Zubin Potok	0	0	0.0	0.0
<b>Gjithsejt:</b>	<b>124</b>	<b>31,203</b>	<b>241.1</b>	<b>178.7</b>

<sup>113</sup> Numri i gjyqtarëve është nxjerrë nga të dhënat e ofruara nga Departamenti i administratës gjyqësore dhe reflekton vendet e plotësuara të punës për gjyqtarë nëpër gjykatat komunale.

**Tabela 9. Mesatarja e numrit të lëndëve komplekse për një gjyqtar në v. 2003**

<b>Gjykata Komunale në:</b>	<b>Numri i gjyqtarëve</b>	<b>Lëndë të pranuar</b>	<b>Norma për një gjyqtar</b>	<b>Lëndë të zgjidhura për një gjyqtar</b>
Gjilan/Gnjilane	6	2,390	398.3	298.3
Kamenicë/Kamenica	3	527	175.7	159.3
Viti/Vitina	3	909	303.0	232.3
Prizren	9	3,844	427.1	257.7
Dragash/Dragaš	5	314	62.8	65.2
Malishevë/ Mališevo	3	610	203.3	163.3
Rahovec/Orahovac	6	1,198	199.7	166.7
Suharekë/Suva Reka	4	762	190.5	172.3
Pejë/Peć	10	1,995	199.5	165.3
Deçan/Dečani	4	576	144.0	153.3
Gjakovë/Đakovica	6	2,546	424.3	222.7
Istog/Istok	3	571	190.3	113.0
Klinë/Klina	3	716	238.7	166.7
Prishtinë/Priština	22	6,991	317.8	141.9
Ferizaj/Uroševac	7	2,440	348.6	226.0
Gllgovac/Glogovac	3	385	128.3	129.7
Kaçanik/Kaçanik	1	1,063	1063.0	451.0
Lipjan/Lipljan	5	823	164.6	147.8
Podujevë/Podujevo	5	1,356	271.2	171.0
Mitrovicë/Mitrovica	9	1,789	198.8	175.6
Skenderaj/Srbica	4	539	134.8	126.5
Vushtrri/Vučitrn	5	1,366	273.2	275.6
Leposavić/Leposaviq	1	200	200.0	18.0
Zubin Potok	1	62	62.0	5.0
<b>Gjithsejt:</b>	<b>128</b>	<b>33,972</b>	<b>265.4</b>	<b>178.5</b>